



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA			
Prenomer - Priftimi i Mëdha	19-12-2022		
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetës Pridig	Vlera Vrednos
01-060/01-1492			



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershori, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e -XI- të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën 27.12.2022 (e Merkur), duke filluar në ora 10:00.  
Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti. Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

### R e n d d i t e

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjet e rregullt e KK-së.
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim-plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011.
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e listës së veçant të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjate vitit 2023.
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores me Nr.01-110/05-1057, të datës 29.09.2022 për taksa, ngarkesa dhe gjoba.
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit Nr.01-110/05-1071 për caktimin e lokacionit për ngritjen e obiliskit Madelein Albright, në qytetin e Vitisë, të miratuar nga KK Viti, me datë 28.09.2022
- Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2022.
- Informatë për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë.
- Informatë për zbatimin e planit te KKSB-së për vitin 2022

Viti, më 19.12.2022

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit

Bekim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### I MBLEDHJES SË DHJETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e stoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 30.11.2022 (e Mërkurë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkyetari, z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Ramadan Deliu, z.Sokol Shaqiri, z.Basri Sylejmani, znj.Valentina Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Ali Bajrami, z.Ekrem Ymeri, z.Arbnora Hajredini, z.Jakup Demiri, z.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emini, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, z.Durim Sylejmani, znj.Lindita Demelezi, z.Majlinda Shabani, z.Taulant Haxhiu, z.Musli Neziri, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, znj.Zyrafete, z.RamaVeton Ramadani, znj.Anisë Zejnnullahu, z.Reshat Azizi, ndërsa mungoi Taibe Ibrahim, Sokol Hyseni, Ilir Zuka. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 23 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e dhjetë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, e nderuar drejtoresh e QKMF-së, media, qytetarë të Komunës së Vitis, prej seancës së kaluar aktet e ligjshmërisë janë në rregull, deri tani të gjitha ato çka janë kthyer nga ministria, të gjitha janë kthyer pozitiv. Edhe njëhere ju uroj festat, faleminderit që ju keni përgjigji ftesave edhe të seancës soleme dhe pjesës tjetër që ka qenë një organizim mjafatë i mirë. Besoj që shumica i kanë marrë laptopat, edhe 4 kanë mbet, të lajmrohen, që ende nuk i kan marrë. Për çdo problem me pjes të instalimeve ose me e-mail zyrtar Sabedini është këtu pjesë e IT-së së komunës sonë. Nga KPF-ja kemi pasë disa kërkesa për informatë sot këtu në kuvend komunal keni një raport për shëndetsi. Para se me ja dhanë fjalën juve t'i jap fjalën drejtoreshës. Meqenëse fillimi shëndetësor i kërkoni fjalën nënkyetari, urdhëroni nënkyetar.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar I komunës:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Në Komitet për Politikë dhe Financa kan dalë 3 kërkesa nga anëtarët e KPF-së, që njëra prej tyre ka qenë edhe informatë lidhur me muajin rozë, të cilët që nga ajo ditë e kërkesës, unë të nesërmë i kam thirrur 3 akterët, drejtoreshën e QKMF-së, e cila e ka përgatit një informatë dhe ma ka sjellur mua në zyrë dhe ju e keni sot këtu pranë jush është kërku edhe një informatë për 16-ditorshin e dhunës në familje, të cilën e kam ftuar edhe drejtoreshën e shëndetësisë. Besoj që do të na bashkangjitet më vonë, por megjithatë kam ftu edhe drejtoreshën e arsimit, se është kërku edhe një informatë lidhur me punën e psikologeve, të cilët kanë startu këtë vitë që po bëhet nëpër shkolla, por me keqardhje duhet të ju them se, ajo është në pushim vjetor dhe këtë informatë do ta merrni në seancën e Dhjetorit, dhe prandaj kam bë përpjekje për ato kërkesa të cilat kan buru apo kanë dal nga anëtarët e KPF-së, të jenë sot në kuvend dhe tash keni rastin nga akteret që kanë qenë në ngjarjet të njoftoheni përvèç me shkrim të cilën e keni,

por ne rast se keni nevoje edhe per pytje i keni ketu. Do te bejme perpjekje cdo here qe te jemi te pergjegjshem për kërkesat e juaja, të cilat mund të dalin si në KPF një ashtu edhe në kuwend. Faleminderit!

**Drejtoresha e QKMF, Vjollca Kadolli:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Bazuar në kërkesen që antaret e KPF-s kanë bër për një informatë rreth aktiviteteve të muajit tetor, muajit të luftes kundër ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit, po e sjell këtë informatë. Jam munduar që në mënyrë të shkurtë t'i përshkruaj të gjitha ato aktivitete që thuajse për një muaj rresht janë realizuar në Komunën e Vitisë, nuk është hera e parë që ne shënojmë muajin rozë, janë vite me radhë që e kemi bërë këtë me përashtim në kohën e pandemisë që nuk ka pasurë aktivitete përndryshe, vite me radhë janë bërë aktivitete të ndryshme qoftë në komuniteti qoftë në qytet ose edhe me shërbimet që janë ofruar drejtëpërdrejt qytetarëve, qoftë nga interesit që kanë patur për ultrazë për mamografi apo edhe me ligjérata të ndryshme dhe shpërndarjen e fletushkave që e kemi bërë thuajse çdo here. Fillimi që jemi dakorduar së bashku me drejtoreshën e DSHMSH-së, kryeshefen e mjekësisë familjare, koordinatoren që e kemi në QKMF-së si dhe me akterët ose punitoret shendetore që do të ishin pjesë e ligjératave. Planin e punës e kemi bërë për muajin rozë, kur jemi dakorduarë që të caktojmë edhe lokalitetet ku do të mbahen ligjératat. Ka qenë një pyetje që është bërë në media ose neve na kanë shkruar direkt, sepse janë caktuar disa fshatra, janë caktu saktësish fshatra që kemi pasur ambulanta për shkak që në kohën kur ne kemi bërë planin, ka qenë koha e mbylljes së shkollave dhe nuk e kemi ditë saktë se a mundemi me i shfrytzu shkollat, mirëpo që mos me pas probleme, jemi caktu vetëm në ato fshatra ku kemi pasur ambulanta. Gjithashtu pasi vetëm kemi fillu me ligjérata, ju a kemi dhënë mundësinë qytetarëve, ata që kanë interes të mbajmë ligjérata edhe në ato lokacione që ne s'i kemi pasur në plan. E njëjtë ka ndodhur edhe në fshatin Goshicë, që nuk ka qenë e planifikuar, por me kërkesën e qytetarëve të Goshicës e kemi realizu, duke ju falenderu edhe drejtorit, e kemi realizu në shkollë. Gjithashtu ja vlenë të theksohet se, të gjitha aktivitetet kanë qenë të prezantuara edhe në mediat sociale, në rrejtin social, faqen e QKMF-së, që e kemi në dispozicion si dhe në media të tjera. Për këtë jam falenderus për bashkëpunimin që keni treguar gjatë kësaj kohe. Fshatrat të cilat janë mbajturë janë në Terpezë, Remnik, Beguncë, Sllatinë e Epërme, Sodovinë e Jerlive, Goshicë, Smirë, në shkollën "Kongresi i Manastirit" në Pozheran, është mbajturë një ligjerat me nxënësit e klasës 11-12 si dhe me arsimtarët e asaj shkolle, edhe kjo ligjeratë është mbajtur me kërkesën e drejtorisë së shkollës. Ajo çka është me i falënderu është edhe doktoresha, e cila ka qenë në mënyrë vullnetare, i ka mbajturë të gjitha ligjératat, doktoresha Gentiana Ferati, e cila çdoherë ka qenë e gatshme me u përgjigji kërkesës sonë, fletpalosje janë shpërndarë në secilën ligjeratë për gratë pjesmarrse, gjithashtu fletpalosje janë shpërndarë edhe në qytet për qytetarët ose kalimtarët e rastit. Ajo çka ka qenë më e veçantë e këtij viti krahasim me vitet e tjera, ka qenë gratë të cilat kanë qenë të prekura me kancer. Shumicën e rasteve na kanë përcjell në aktivitetet, në shumicën e aktivitetet kanë prezantu edhe një ligjeratë edhe kanë folur direktë për sfidat, provojen e tyre, problemet me të cilat janë përballur e kanë shpreh provojen e tyre drejtpërsëdrejti për pjesmarrësit aty. Në bashkëpunim me Karitas Kosova kemi mbajturë një ligjeratë për punitoret e Karitas Kosova që janë të angazhuarë tek ne në QKMF, edhe këtu duhet ta falënderoj drejtorin e shkollës "Dëshmoret e Vitisë", i cili ka shpreh një bashkëpunim dhe na ka dhënë mundësinë që ta mbajmë aty. Ligjérata është mbajtur nga një psikologe nga Gjilani, Aferdita Keqiku. Kanë qenë pjesmarrës vetëm punitoret e Karitas Kosova. Aktivitetet tjera që kemi bërë ne, fillimi që muajin Shtator e kemi bërë një kërkesë direkt SHSKUK-së për sigurimin e mamografisë mobile. Ne kemi provojën që 1 muaj, e kemi pasur para 2 viteve mamorafinë në Viti, e kemi pasur edhe më herët në vitin 2015, ndërsa kur ne kemi kërkuar që të fillojmë ose tërë muajin ose të kemi nga fillimi, ata e kanë pasur në servisim. Derisa është bërë servisimi, nuk kemi mundur me siguru në Viti, megjithatë mund ta theksoj se, komuna jonë ka qenë komuna e parë e cila ka arritë sivjet me pas mamorafinë mobile në Republikën e Kosoves, dhe në Viti ka qëndruar për 4 ditë, ku gjatë kësaj periudhe janë kryer 41 mamografi. Pse nuk ka pas më shumë domethanë është e caktuar për shkak që ambienti është shumë i ngushtë aty edhe është një punitor që vjen aty nga qendra dhe nuk guxon më shumë me qëndru në atë ambient për shkak të rrezikimit të shëndetit punëtorëve që punojnë aty. Ajo çka ka qenë karakteriste, kemi pasur

marreveshje me spitalin rajonal te Gjilanit, spitalin e per gjithshem te Gjilanit, ku per kete jemi takuar me dr.Arsim Eminin dhe jemi dakorduar që çdo ditë në koordinim me punëtorët e repartit të radiologjisë, të bëjmë 3 deri 5 gra, ku ne gratë i kemi marrë në bazë të rradhitjes se si janë lajmruar në telefon. Kemi pasur një numër të telefonit të një punëtori tek ne ku janë lajmruarë ose edhe janë lajmru direkt dhe në bazë të kësaj rradhitje i kemi dërguar emrat në Gjilan. Ka pasur prej tyre që i kemi larguar nga lista, i ka largu në të vërtet edhe Gjilani për shkak të moshës që ka qenë më e ulët është mirë me u tregu edhe kjo se jo të gjithë e kanë marrë shërbimin sepse ka pasurë që janë lajmruarë edhe nën moshën 45 vjeqare Gjilani e ka pasë striktë mbi moshën 45 vjeqare prandaj edhe ato janë largu me kohë nga lista ose nuk janë dërgu fare ose ne i kemi kontaktu i kemi lajmru përmes telefonit, në mesin e atyre ka pasë edhe ato që kanë qenë të diagnostikuara me kancer edhe janë lajmru për mamografi edhe atyre nuk i janë kryerë në këtë kohë për shkak që kjo është një formë skriningu dhe kur bëhet skreningu bëhet me pacientet ose me qytetaret të cilat nuk kanë diagnozë domehtanë ka pasë raste që janë larguarë dhe me të kan biseduarë edhe vetë direktë dhe ju kam treguarë si kur rasti i fundit sotë vetëm ja caktum njërsë prej tyre terminin e rrijë në Gjilan aty e kemi largu sepse ka qenë skreningu dhe në skreningu nuk merren parasysh ato të cilat janë në diagnozë por ato të cilat dëshrojnë të vërtetojnë se a kanë ndonjë ndryshim apo jo, gjatë ksaj periudhe vlen të theksohet që jan kryer 104 mamografi nuk jan kryer vetëm gjatë tetorit ne kemi bërë bashkëpunim me Gjilanin edhe në muajin nëntorë ato të cilat na kan mbetur i kemi caktu tërmine edhe gjatë muajit nëntorë të gjitha rezultata kemi shkuar i kemi marrë ne vetë ose na e kanë sjellurë qytetaret që kanë qëllu në repartë ndërsa qdo paciente e kemi thirrur në telefonë në momentin pasi e kemi marrë rezultatin e kemi obligu me ardhë në mënyrë që mos me hargju fare në aspektin finansiarë nga mjeku familjarë i cili ka qenë i caktuarë ju ka paraqitë rezultati në bazë të dokumentacionit që e kemi marrë qoft nga spitali i Gjilanit qoft edhe nga SHSKUK ,tjetër qka ka qenë me rëndesi ishte edhe organizimi i marshit ku bashk me shumë akter në komunën e Vitisë përfshir institucionet komunale kuvendin komunal antaret e kuvendit grupin e grave të Vitisë drejtorit e administratave kemi bërë organizmin e marshit sensibilizues një marsh i cili është bër i natyrshëm tek ne në qendër të qytetit dhe aty përpos që kemi qenë ne kanë qenë të ftuarë edhe nga spitali i Gjilanit edhe nga SHSKUK-ja mirpo informatën e kemi dhanë shum vone dhe ka qenë epamundur që të marrin pjes, jam faleminderuese për të gjithë ata të cilët na kanë ndihmu mendojë që të gjitha aktivitetet janë realizuar sipas planit që e kemi bërë në fillim jam shum e kënaqur nga të gjithë edhe nga rezultatet që i kemi marrë fatmirisshtë nuk ka asnjë këtë vitë dallim prej herës së kaluarë që kemi pasë 4 gra që vetëm kan qenë të diagnostikuara me kancer pas skriningut që e kemi bërë kanë dalë mir mirpo edhe interesimi i qytetareve është rriturë shum për të marrë informata tek ne dhe thuajse qdo ditë kemi qytetarë që vinë dhe marrin informata, ajo qka më është thënë nga akteret e institucioneve komunale ka qenë edhe një pyetje se a ka pasurë interesim këtë vitë apo viteve të kaluara interesimi ka qenë më i vogël këtë vitë në krahasim me vitet e kaluara ndoshta kjo përfaktin se në vitet e kaluara kur ne kemi pasurë mamografin mobil Ferizajin Gjilani nuk kanë pasur në dispozicion dhe tanë kanë edhe atje dhe qytetaret e kryejnë direkt gjithashtu të gjitha qytetaret i kemi njoftu që mamografia në Gjilan punon qdo ditë ndodhë që nuk ka nevojë me caktu termin vetëm shkonë me udhëzim prej nesh aty është e rregulltë ,në 2018 numri i grave që kanë shprehur interesim në listat që i kemi pasurë ka qenë mbi 600 ndersa tanë këtë vitë ka qenë mbi 200 mundë të them qe 145 e kan kryer mamografin dhe të tjerat më nuk jan lajmruar edhe pse ekemi lanë diskutimin hapurë për të gjitha ato që kan interesim në bashkëpunim me spitalin e Gjilanit do të mundohemi të ja cakojmë tërminin pasë kësaj kohe, është hera e parë që më është kërku një informatë jam e gatshme që sa here që ka nevojë përf qfardo që ka lidhje me shëndetin në komunën e Vitisë jemi të gatshme aq sa dimë të paraqitemi para jushë, nëse ka ndonjë pyetje nga ju Faleminderit.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Para se të hy në rend dite kemi pyetje dhe pergjigje

**Znj.Majlinda Shabani:** Pëershendetje për të gjithë të pranishmit! 25 Nëntori është dita nderkombetare e eliminimit të dhunës ndaj gruave dhe vajzave. Në 16 ditshin e aktivizmit kundër dhunës në bazë gjinore duhet

t i bashkohemi edhe ne si kuvend komunal, kjo permes raportimit nga Keshilli komunal per Siguri ne Bashkesi ose Zyra për të Drejtat e Njeriut apo qoftë në aspekt sensibilizues, andaj konsideroj se, kjo është shumë më rëndësi të diskutohet si pikë e rendit të ditës nga kuvendi komunal, pikërisht këtu statistikat tregojnë numër shqetësues të raportimeve mbi dhunën në baza gjinore, dhunën ndaj grave, andaj angazhimi ynë për të luftuar këto dukuri është mëse i nevojshëm, i domosdoshëm nga gjithsecili prej nesh. Dhuna në familje, dhuna në baza gjinore nuk është qështje private. Trajtimi me seriozitet dhe bashkimi ynë në luftimin e kësaj dukurie duhet të jetë angazhimi i gjithësecilit prej nesh. Të gjitha këto janë mëse të nevojshëm. Më lejoni t'i përmendi dy aspekte serioze të efektit të stigmatizmit që i bëhen viktimës. E para është ridhunimi dhe inkurajimi i dhunuesve për të kryer akte tjera të dhunës. Të gjitha këto natyrishtë që e dekurajojnë denoncimin. E vërteta është se, komentet ndikojnë, andaj ne duhet të dijmë që asnjëherë viktima ose e mbijetuara nuk duhet të jetë fajtore. Siguria, mirëqenia dhe dinjiteti i grave duhet të mbrohet, integrimi i tyre në shoqëri përmes mbështetjes tonë institucionale, përmes mekanizmave insteticional duhet të ofrohet. Ato duhet të mbrohen, andaj sot përmes ulëses së kuvendit komunal. Unë ju them të gjitha grave dhe vajzave të raportojnë dhunën, as edhe një më shumë. Meqenëse kam edhe 1 minut në pytje dhe përgjigje, unë kisha dashtë me u ndalë te konkursi publik, i cili është bërë për ndarjen e bursave për studentë, ku në pikën e 3-të, kriteret për aplikim, thuhet që, duhet të janë studentë të fakulteteve drejtime deficitare, si: Matematikë, Fizikë, Gjuhë Gjermane. Fillimisht mendoj që, këtu formulimi është gabim. I kuptoj statistikat ose specifikat që Komuna e Vitisë mundet me i pas, mirëpo mendoj që kisht qenë mirë me qenë përparsi dhe jo me i obligu që me qenë drejtime deficitare, për shkak që po bëhet një diskriminim ndaj drejtimeve të tjera. Tjetra është që, edhe për faktin që Buxheti Komunës së Vitisë për këtë vitë është rritë, mirëpo nuk kam pa shtim të mjeteve të bursave për studentë, madje kjo ka qenë edhe kërkesa në dëgjimet publike që është bërë edhe premtim i kryetarit. Po besojë që të gjithë e kemi parë lajmin shqetësues të Premten, ku rreth orës 18:00 ka ndodhë një plagosje e të rinjeve të Komunës së Vitisë, andaj kërkesa e imja është që, si institucion të punojmë më shumë rreth sensibilizimit, qoftë përmes tryezave sensibilizuese, në mënyrë që të ndikojmë që këto dukuri me u parandalu. Faleminderit!

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pjesa që jemi është pyetje përgjegje. Ju kisha kërkua që të ju përbaheni planit. Nuk është në atë pjesën e komenteve. Kërkon një pikë të rendit të dites, kërkoi një informatë. bisedojmë për qka doni, mirëpo pjesa tashti është vetëm pyetje përgjegje. Ju kisha kërkua me qenë në temë.

**z.Jakup Demiri:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë i kam dy pyetje, do të thotë një pyetje dhe njëra më shumë informatë. Pyetja është për komunën, trotuari në Smirë që ka fillu tash 2 vite, që kap terenin prej shkollës dhe vazhdon nga “Lagjja Alijaj”, i cili nuk është përfundu dhe punimet mendoj që janë jashtë standardit të cilat duhet të janë aty, dhe është mirë të shkohet të shikohet dhe të bisedohet me banorët, se ata i kanë edhe do halle të tjera. Dhe tjetra për ndriqimin publik, i cili funksionon edhe gjatë ditës jo vetëm në Smirë, por edhe në disa fshatra të tjera, mandej edhe në disa pjesë të qytetit të Vitisë, unë vet i kam parë edhe te lumi “Morava” dritat gjatë ditës të dhezura. Faleminderit!

**z.Taulant Haxhiu:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë po shof që Vitia po zhvillohet, po ndërtohet. Kjo është mirë për qytetin, por deshta të dijë këto ndërtimë që po bëhen vazhdimesh në Komunën e Vitisë, a kanë leje të ndërtimit a i plotësojnë kriteret e ndërtimit apo ata po lulëzojnë në ndërtim pa e plotësuar një kriter të vetëm. Unë deshta të ja bëjë pyetjen edhe drejtorit të inspeksionit: a kanë leje ndërtimi? Dhe drejtorit të urbanizmit, se ato po janë 7-8 e 9 katë: a i plotësojnë kushtet dhe a kanë leje të ndërtimit këto ndërtesa që po ndërtohen? Nuk jemi kundër ndërtimit, por në çdo qytet çdo vend të botës duhet të plotësohen kriteret, duhet të jepen lejet dhe jo të ndertojnë pa asnjë kriter apo pa asnjë leje të dhënë nga Komuna e Vitisë. Varsisht, qytetarët kanë ankesa. Këtë pyetje para kësaj seance e kanë bërë edhe kolegët e mi nga subjekte të tjera politike, po unë po du me ditë decidiv si është puna me këto ndërtimë dhe a kanë leje a jo. E dyta, disa deponi sidomos në drejtim të fshatit Stubëll. Unë zakonisht shkoj atje, por atje komuna po pretendon të jetë si vend turistik, pasi që e dimë që në stubëll është edhe shkolla e parë shqipe. Nënkyetar, duke shkuar rrugës për Stubëll janë ato deponitë e

berilogjitet qe une kur po i shohe tmerrshem. Ne po kemi vizitore aty, kemi restaurante te njottura, qe shumica vime edhe prej vendeve te tjetra. Aty eshtë bëre sidomos kur ta kalojsh restaurantin "Fraklin Haus" përtej Karadakut nga ana e majtë, aty eshtë një deponi e tmerrshme që për sytë e qytetarit eshtë katastrofë. Unë kërkoj që menjëhere të merret masa, të pastrohet, komuna po donë me investu me bë atë pjesë si vendë turistik, për sy të qytetarëve dhe për sy te vizitorëve eshtë e tmerrshme. I ndruari nënkyreatar, unë ti kam bëre dy pyetje për lagjen "Hasan Prishtina", ti e dinë për iniciimin e një trafe dhe për rregullimin e ujësjellësit, besoj që sot ki ndonjë përgjegje që ta dinë qytetarët se çka do të bëhet me ta. Eshtë një ndër lagjet më të populluara në Komunën e Vitisë.

**znj.Lindita Demelezi:** Përsendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja eshtë për organet kompetente lidhur me sigurinë e banorëve të komunës sonë, lidhur me vjedhjet e shumta që kanë ndodhur kohëve të fundit, gjë që eshtë shqetësim shumë i madh për banorët dhe i lusim përgjegjësit, që në seancën e radhës të vijnë dhe të sqarojnë lidhur me gjendjen e sigurisë. Po ashtu organet komunale të mendohen për këtë se, çka duhet e mund të bëhet që të shtohet siguria e banorëve.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit Lendita! Organet kompetente, policia nuk na raporton ne, po prej Këshillit për Siguri në Bashkësi besoj që mundet me na ofru një informatë.

**z.Musli Neziri:** Përsendetje për të gjithë të pranishmit! Fillimi i shumë afér gjithë qytetarëve kudo që jetojmë, meqenëse kësaj radhe jemi modernizu pajisje me lap-top kshilltarëve komunal, ju uroj punë të mbarë, por kërkoj edhe përgjegjësi për këto pajisje. Pyetja e parë e imja do të ishte për drejtoreshën e arsimit, por meqenëse mungon ajo, eshtë në pushim vjetor, do ta kisha drejtu te nënkyreatri. Nuk e di a eshtë i informum se, qendra e karrierës në shkollën e arsimit dhe aftësimit profesional "Jonuz Zejnullahu" në Viti ka dorëzu një kërkesë për sigurimin aksidental të nxenësve në vendin e punës dhe këtë e kemi ngrit si Komitet për Arsim, ku kemi kërkuar që kjo eshtë edhe me udhëzim administrativ. Domethanë ky udhëzim 137220 e kërkon një mbulim të kostos së tillë, prandaj krejt çka kisha kërku që, Drejtoria e Arsimit të ulet me zyrtarët e qendrës së karrierës, të gjejnë modalitetin. Ata janë në gjendje që të ndihmojnë në këtë aspekt dhe të ulen dhe të mbulohet. Kostoja e sigurimeve të nxenësve aksidental, sepse kjo eshtë një kërkesë edhe e bizneseve që të mundë të përkrahen nxenësit për kryerjen e praktikave profesionale. Drejtoresha ka qenë edhe më herët e njoftuar për këtë, ka thënë se do të bëjmë diçka, ende zyrtarisht nuk eshtë arrit ndonjë rezultat në këtë fushë, prandaj po kërkoj nga Janari i 2023 të ketë një mbulueshmeri të tillë. Ndërsa pyetja e dytë ka të bëjë me asfaltimin e disa lagjeve në fshatin Ballancë. Aty kanë fillu disa punime dhe këtë eshtë mirë ta marrin shumë seriozisht organet kompetente të komunës. Nuk e di asfaltimi a duhet të bëhet për gjithë qytetarët njëjtë apo duhet bëhet me diferençime, prandaj mendoj që qytetarët e Komunës së Vitisë dhe banorët kudo që jetojnë, cilës do lagje, cilin do fshatë duhet të trajtohen me dinjitet të barabartë. Ashtu si thotë populli, një thënie jo për dikan nan e për dikan njerkë. Ky për dikan nan e dikan njerk, ne të jetë një mesazh edhe për kualicionin qeverisës në nivel lokal. Faleminderit!

**z.Nexhat Halili:** Përsendetje për të gjithë të pranishmit! Në seancat e kaluara kam bëre pyetje për projektet, rruga "Ali Muhamheri" dhe rruga "Beqir Kurti", në të cilën nënkyetari i komunës ka premtu që, në këtë seancë do të sjellë përgjigjen për këto dy projekte. E njëjta eshtë edhe për projektet e tjera, trotuarin i cili lidh Trestenikun, Sodovinën e Muhamherve, Sllatinën e Epërmë, ndriçimin publik në fshatin Sodovinë e Muhamherve dhe trotuarin në Sodovinën e Jerlive dhe Sodovinën e Muhamherve, mirëpo unë nuk po shofë që ka pru ndonjë material për të kthyer përgjigje. Pyetja tjetër eshtë, asfaltimi i rrugës Sllatinë-Viti, faza e dytë. Kontrata eshtë e lidhur me 20-09-2022. Vlera e kontratës eshtë 544 mijë e 251.89 euro, kjo kontratë eshtë 3-vjeçare, sipas njoftimit për kontratë vlera e planifikuar eshtë 390 mijë euro sipas buxhetit të publikuar në web-faqen e ministrisë për vitet 2022-2023 dhe buxhetin e komunës sonë. Vlera e ndarë 391 mijë e 132 euro, diferenca mes këtyre dyve eshtë 153 mijë e 119. 89 euro. Pyes nënkyrearin por edhe drejtorin e buxhetit se, ku do t'i merrni këto mjete, diferençën mes këtyre, a e keni planifikuar se ku do ti merrni këto mjete për mbulimin e projektit. I njëjti rast eshtë edhe te asfaltimi i rrugës rurale në Komunën e Vitisë, vlera eshtë 1 milion e 299 mijë e 973, e cila eshtë lidh

kontrata, ndersa vlera e parashikuar sipas buxhetit eshte 1 milion e 80 mijë, diferenca eshte 219 mijë e 9/3. Edhe këtu bëjë pytje: a e ka planifikuar struktura udhëheqëse se, ku do t'i marrin diferencën e këtyre mjeteve, me çka do ta mbulojnë këtë projekt. Faleminderit!

**zpj. Anisë Zejnnullahu:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Qytetarët tanë në vazhdimsi janë në pritje të përmisimit të infrastrukturës dhe kushteve më të mira për jetesë, ne jemi zëri i tyre, andaj edhe kërkuesat e tyre në vazhdimsi do i paraqesim deri në realizimin e tyre. Kërkesa e parë ka të bëjë me sanimin e rrjetit egzistues të ndriçimit si dhe zgjerimin e rrjetit ndriçues edhe në rrugët e lagjeve të fshatit Ramjan për të lehtsuarë lëvizjen e fëmijeve gjatë kthimit nga shkolla në orët e mbrëmjes. Jemi dëshmitarë që, qentë lirisht po bredhin rrugëve dhe rrezikojnë në vazhdimsi kalimtarët në rrugë. Ndërsa kërkesa e dytë ka të bëjë me rregullimin e rrugës, asfalti në hyrje të fshatit Ramjan në afersi të fshatit Dardani është i demtuar shumë dhe është rrezik për të dëmtuar automjetet, por edhe për të shkaktuar aksidente gjatë kyqjeve apo qkyqjeve në rrugën magjistrale Gjilan-Ferizaj. Kërkesa që u shtruan këtu nuk janë shumë të kushtueshme, por janë shpresëdhënëse që ne jemi afër qytetarëve dhe po ua kthejmë kontributet e tyre ashtu si e meritojnë. Faleminderit!

**Znj. Zyrafete Rama:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pas shumë kërkeseve dhe vërejtjeve që më janë adresuar këto ditë nga banorët e fshati Zhitit, rrëth punimit të trotuarit, dëshiroj që, edhe përmes kuvendit t'i paraqes shqtësimet e tyre për vonesën e paarsyeshme të trotuarit, e pikerisht për cilësinë e dobët që nuk e plotëson asnjë standartë të punës për t'i dëshmuan më saktë këto punime shkel e shko dhe shkatërrimin e trotuarit ende pa përfundu ai. Kam sjellur si dëshmi disa foto që paraqesin gjendjen faktike të tij, pra, këtu i kam disa foto ku shifet qartë puna e trotuarit ende pa përfundu as 50% e trotuarit, është shkatru, andaj kërkojë nga ju nënkyetarë, t'i merrni masat e duhura bashkë me organet kompetente, që mos lejoni keqpërdorimin e buxhetit komunal, po ashtu edhe të qytetarëve tanë, ndaj të merrni masa konkrete ndaj kompanisë punëkryerese. Faleminderit!

**z. Ali Bajrami:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Në seancat e mëparshme prej kryeatrit komunës na kanë ardhë dy propozim vendime për dhënien e pasurisë, pronën komunale përmes ankandit. Kërkoj informatë apo njoftim, a është kryer ankandi, kush është përfitues dhe sa është vlera monetare e dy ankadeve që ne i kemi votu, që është dashtë me na informu nëse kanë përfundu. Faleminderit!

**zpj. Vilsona Maliqi-Salihu:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë pata të njëjtën pyetje si kolgu Jakup Demiri, për rrugën “Hysni Salihu” në fshatin Smirë. Dua të dijë, kur pritet të përfundojnë punimet, sepse ky trotuarë është shumë i nevojshëm për qytetarët, sidomos për nxënësit e shkollës që është afër. Faleminderit!

**Znj. Liridona Bislimi:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë kam parë se kanë filluar të bëhen disa punime tek rruga “Brigata 173”, këtu në Komunën e Vitisë, dhe më intereson ta dijë se, për sa kohë parashihet që të përfundojnë këto punime, më konkretisht janë të pjesa ku gjinden para shtëpizave prej drurit. Edhe nëse mund të kem informacione se, çka do të punohet më shumë në kuadër të këtij projekti. Unë kam bëré një pyetje të ngjashme në dokunete zyrtare, por realisht nuk është se kam pasur ndonjë përgjegje të specifikuar, prandaj nëse ka mundësi te kem këtu më shumë informacione. Gjatë mandatit të kaluar, prej banorëve të fshatit Drobesh e kam dorëzu një kërkësë tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, për vendosjen e një trafo elektrike së bashku me miratimin e këshillit të fshatit dhjetra nënshkrime dhe nga banorët si dhe kërkesa për lejmin e parcelës për vendosjen e trafos elektrike. Njëri nga banorët e fshatit që e kemi dorëzuar tek AKP-ja në Gjilan, këto veprime i kemi bëré para disa viteve me drejtorin e atëhershem dhe kemi qenë në kontakte të vazhdueshme, duke tentu me gjetë një zgjidhje sa më të përshtatshme dhe imanente. Vlenë të ceket dhe gjatë stinës së dimrit dhe me ardhjen e mërgatës ku ka ngarkesë të madhe të rrjetit elektrik, duke filluar nga banorët e rrugës “Guresel e Bajram Sylejmani” dhe disa lagje të tjera në rrëthin, ata përballen me mungesë të energjisë elektrike dhe ajo energji elektrike që shpërndahet është jashtëzakonishtë shumë e dobët. Kështu duke ju shkaktu dëme shumë të mëdha financiare, sidomos atyre që kanë punëtori e firma. Pyetja ime është kjo, a ka filluar drejtoria e juaj ta marrë parasysh këtë kërkësë serioze që është dorëzu para disa vitesh, edhe nëse jo, kur do të mund ta kemi një përgjigjje të plotë mbi këtë problematikë. Faleminderit!

**z.Sejdı Emuni:** Pershendetje per te gjithe te pranishmit! Sot do ta riperseris nje kerkese qe ka te beje drejtpërdrejt me interesin dhe sigurinë e qytetarëve të komunës sonë, konkretisht në qendër të Vitisë. Edhe më herët kemi kërku, kemi potencu, kemi arsyetu, se në vend kalimin ku ka zebra është e nevojshme dhe është e domosdoshme me u bë edhe shenjat ndriquese natën për dy arsy. E para, sepse i krijon siguri këmbësorët, e dyta shoferit makinës pse jo të mos ketë edhe estetikë si në qytetet tjera të Kosovës. Mendoj që nuk është kosto e madhe, mirëpo e zgjedh një problem bukur të ndjeshëm që është mjaftë shqetësues në komunën tonë. E dyta ka të bëjë me gropat septike të kanalizimeve, të cilat ende nuk kanë gjetur zgjidhje përfundimtare. Një e tillë është edhe në Sodovinë, ku edhe rrugës magisitrale për Ferizaj kundërmon erë. Është mirë që përfundimisht me i bë zgjidhje ksaj çështje, sepse është një pyetje edhe shëndeti. Faleminderit!

**z.Basri Aliu, drejtori:** Përshtendetje për të gjithë të pranishmit! U bënën disa pyetje lidhur me drejtorin e shërbimeve publike. Do të mundohem të japë përgjegje me qëllimin më të mirë që, të arrimi edhe efikasitetin. Derisa po debatojmë, Jakupi e përmendi ndriçmin që po mesin edhe ditën nëpër fshatra. Është e vërtet se në disa fshatra edhe kur punohet mundet me qenë ndriqimi dhezë për arsy se me ditë ku janë defektet, por edhe prej qytetarëve të pandërgjegjshëm të cilët e prekin, e lajnë gjithë ditën për me nejt 24 orë dhezë. Unë kam bisedu me Jakupin, duhet me na njoftu neve mos me prit veç në kuvend me e paraqit këtë, se ne nuk mundemi me qenë gjithmonë në vendngjarje. Taulanti përmendi mbeturinat në rrugën e Letnicës. Është e vërtet, por ne shpeshherë kemi intervenu dhe i kemi eliminu, por prej qytetarëve dhe bizneseve të pandërgjegjshëm nuk pe mirmbajnë në këtë kuptim, por ata po hudhin prapë. Unë ju kisha lutë sikur çdoherë aty ku jeni vepronni, ndikoni që mos të hudhen mbeturinat edhe Taulanti që vjen prej fushës, biznesit që të flet me ata e të mos hedhin aty ku nuk e kanë vendin. Trafa në Drobesh. Para disa ditëve e kam pas një takim me drejtorin e KEDS-it të rajonit të Gjilanit dhe kemi bisedu bash për këtë çështje, edhe pse kjo është në domenin e KEDS-it, nuk është në domenin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, por ne për hirë të interesit të qytetarëve po bëjmë trysni nganjëhere që ta shtrojmë ndikimin në këtë kuptim, por sipas tyre sivjet nuk kan investime rreth trafave, kështu që mbetet kjo çështje ende në zgjidhje të mëtutjeshme. U përmend edhe shtrirja e ndriqimeve nëpër vende ku nuk ka. Është një marrveshje e cila është bërë përmes kryetarit, që do të bëhet ndriçmi në gjithë territorin e Komunës së Vitisë përmes eficiencës për ndriçim, që është edhe këto që janë egzistuese do të ndërtohen në mënyrë që të kemi kursim të energjisë elektrike dhe për sivjet dhe qeveria na e ka pru do vendime që ndriçimin duhet ta kursejmë. Kështu që, edhe kur të prishet nganjëhere mos insistoni aq shumë, është problemi se edhe ashtu kemi telashe në këtë drejtim. Faleminderit!

**z.Visar Demiri, Drejtori:** Përshtendetje për të gjithë të pranishmit! Tek pyetja e këshilltarit komunal, Taulant Haxhiu, rreth lejeve ndërtimore ose objekteve pa leje në Komunën e Vitisë, po ju informoj se, në komunën tonë si në krejt Kosovën numri i objekteve pa leje është shumë i madhë, dikund të regjituara i kemi mbi 4000, por që nuk është numër ndoshta i saktë, ka edhe më shumë te këto të banimit kolektiv. Planet rregulluese që i kemi në qytetin e Vitisë, por edhe si i parashohin nderimin deri në 6 kate, ato që janë mbi 6 kate nuk kan leje për ndërtim. Faleminderit!

**z.Hasan Aliu, nënkyrytar I komunës:** Faleminderit Kryesues! Kam bërë përpjekje dhe me i shënu gjithë, por problematike me i zanë të gjitha, por kam ardhë në përfundim edhe nga seanca e kaluar edhe nga kjo ndoshta shumë më mirë do të jetë seanca e Dhejtorit dhe të gjitha ato ankesat në adresë me nxjerr njëhere atë të përgjithshmën. Tani ndalemi ashtu pyetjet si janë bërë dhe do të insisitoj të gjithë ata që i kemi mbikëqyrës, komisionet që të janë në seancën e ardhshme këtu dhe të gjitha hollsitë që keni me i shtru, pyejte këtu të përgjigjen se janë puntorë, janë sherbyës civil të komunës sonë dhe të gjitha pyetjet tuaja janë në adresë edhe të implemetinimit dhe të afatit të kryerjes së punëve dhe të kualitetit, do të ishte shumë më mirë në prezencën e tyre. Janë diku rreth 5-6 pyetje në adresë të trotuareve, duke fillu prej Smirës, Zhitisë, Ramjan, serish në Smirë dhe në Trestenikë dhe prandaj do të ishte shumë me ma kompetencë me folë edhe me mbyll ndoshta këtë çështje një here e përgjithmonë kur e them në këtë formë për shkak se ata do të porosisë që të na e sjellin edhe kontratat

edhe planin dinamike te cilët e kane, por edhe ne kualitet, sepse nuk mundem une me i thane se nuk je tu e kry mirë, se unë jam juristë duhet me i thanë një ndërtimtar, prandaj krejt në këtë kontest me naj lehtsu punën edhe juve edhe mua, por edhe ju me marrë përgjigje më të afërt në rastë se pajtoheni. Unë i dëgjova krejt ato diskutime, ndoshta një çështje që do të dalemi shumë më mirë me lajen e juaj këtë mundë të bëjmë. Ata janë puntorët tanë dhe e kanë obligim saherë të kërkohet prej kshilltarëve në aspekt teknik ta përmbushin punën e kuvendit. Majlinda e ngriti një shqetësim, ka qenë shqetësuese për të gjithë edhe për ne çështja e nxënësve. Ne po bëjmë përpjekje në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Deri tash nga raportimet të cilët i bënë komandati i policisë thotë është në ramje këto dukuritë, duke fillu edhe vjedhjet edhe rastet sikur i të Premtes, megjithatë ka ndodh, ka qenë shqetësuese për të gjithë, se ata janë fëmijët tanë, pavarsisht në rastë se nuk e prek drejtperdrejt familjen, por ai është fëmijë i joni të cilët duhet t'i sigurojmë siguri, megjithatë për keqardhje ju deshirojmë sherim sa më të shpejt, duhet të i ndërmarrim të gjihta masat dhe ta sigurojmë, por ju e dini se çështjen e sigurisë e ka policia, e ka edhe rrathi familjar, e ka edhe shkolla të cilët se sa arrim ne me i eduku ata femijë të cilët po i qojmë për nxënien e diturisë dhe jo me shkaktu asi telashe të cilët janë breng për shoqërinë. Do të ndalem te ujësjellësi Taulant, për shkak se kam bisedu bukur shumë, por megjithatë nuk pritet diçka për te ujësjellësi. Tashti është ndërru një bordë i drejtorëve në "Hidromoravë", është ndrru edhe një drejtor, kanë bërë një zotim të cilët me të vërtet do të jetë një bashkëpunim shumë më i mirë edhe më frytdhënës, mund ta quaj edhe për qytetarët e Komunës së Vitisë, por edhe për lokalitete, por megjithatë mbetet me u pa në vitin 2023. Viti 2022 ka qenë vit të cilën marrëveshjen të cilën e kemi pas me CDI-në është e parealizume, nuk e di sa here kam thirrë në telefon, nuk e hapin as telefonin, këtë brengë e kemi pas edhe në konferencën që e ka organizuar para pakë ditëve, që e ka ngritë kryetari si shqetësim, që ka qenë pjesëmarrës edhe KFOR-i, ka qenë edhe drejtori i bordit edhe drejtori i "Hidromoravës", megjithatë gjendjen e kemi këtë që e kemi dhe nuk pritet në këtë vit diçka. Në vitin 2023 të shofim gjithçka. Derisa ta shofë vetë me sy edhe ta preki nuk jam tu i besu kësaj çështje, për shkak që angazhimet e mia në adresë të asaj janë të shteruara në ralacion me atë dhe tashti ndoshta formula më e mirë do të ishte ato marrëveshje të cilët i bëjmë vetëm me "Hidromoravë" tu e përjashtu CDI-në, se me të vërtet i ka përzi punët dhe nuk ka bërë asgjë ajo të cilët na kanë thanë seç janë zotu për këto 5 fshtara me të cilët e kanë ujin, por gjithëhere e kanë thanë mangan. Ka kërku edhe drejtori prej entit higjenikë vet me ardh me kontrollu, se nuk ju ka besu edhe kompanisë ndoshta tu dashtë me i ikë asaj çështje për marrjen në menagjim gjithëher e kanë qitë elementin e manganit. U kërku një palë e tretë profesionale që me fillu me lëvizë në drejtim pozitiv në këtë çështje. Çështjen e sigurisë që e ngriti edhe çështjen e vjedhjeve edhe çështjen e rrahjes Lenditë, është kompetencë e policisë. Unë mundem me i ftu, por nuk janë obligativ me ardhë ata me na raportu neve. Në rast se minden me pasë mirëkuptimin, kapiteni vjen gjithëhere në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi edhe pse si anëtare i mbaj mbledhjet e hapura, minden me ardhë me i marrë informacionet e plota, nuk e di sa ja lejon ligji me ardhë ai para kuvendit me na tregu për këtë çështje. Unë mundem me bisedu në aspekt kolegial, por në aspekt me obligu as unë as kryesuesi nuk besoj që mundemi me bë këtë çështje se i ka ai edhe ditën e raportimin, gjithëhere i thirr organet komunale kur raporton para regjionit ku jep përgjegjësi, por në kuvend nuk ma merrë mendja. Profesorë i nderum, qendra e karrierës mbulimi i asaj kostojë, mirë që e ke ngritë, është mirë me bë së bashku me drejtorin e shkollës dhe së bashku me drejtoreshën me shiku mundësinë se sa i kemi mundësitë buxhetore, jamë për me i mbulu. Mos e merr në atë aspektin që po du me të kundershtu, por mu dokë një fjalor jo adekuatë për Ballacë, po rregullohet diçka dhe dikun nan dikun njerk. Një terminologji e jotja, që unë besoj se edhe kshilltarët e kuvendit komunal, në rastë se i merr, asnjë nuk keni lindë për një ditë, prandaj edhe projekte duhet me i kuptu në këtë forrmë, se për një ditë nuk bëhen të gjitha. Tashti varsishtë se këshilli i fshatit kujtë i ka dhanë përparsi dhe ato shtrohen, por unë besoj që në Ballancë është tu punu vazhdimisht dhe është tu punu bukur shumë. E dinë edhe ti këtë çështje, prandaj nuk na duhet kjo terminologji, por prioritet janë ato të cilët i caktoni në kshillë të fshatit. Në kshill të fshatit, në rast se kanë me u shtru dy rrugë, ju i jepni se cilat kanë me u shtru besoj që ato shtrohen. Nexhat, besoj që këto diferenca në kontratë vazhdimisht po i thu, besoj

qe Jane personat adekuat qe do te merren, besoj qe askujte komuna nuk i mbetet borgj, sikur qe nuk i ka mbetur deri tashtë, dhe besoj që do të i rregullojmë edhe ato çështje të aspektit ekonomik dhe të aspektit në Ligjin mbi Financa. Sa kanë të drejtë unë besojë që ata të cilët i kanë lidh kontratat, besoj që këtë punë e njohin dhe besoj që e kanë pas atë të drejtë. Zyrafete vlenë ajo që e thashë, do të thiri ata inxhinerë, besoj që pajtoheni krejt edhe komisionet mbikëqyrës, krejt ata inxhiner pak që i kemi krejtë janë nëpër komisione mbikëqyrëse, janë mbikëqyrës edhe ata do t'i sjellim edhe për mi pranu punët, mos me i lanë cili është mbikëqyrës në komision për pranim teknik, se është konfliktë, nuk i lamë përndryshe, ata do të jenë për qështjen që e the keqpërdorim të buxhetit komuanl. Si këshilltare nuk kisha qefë më të nij kurrë, atë e perdon dikund tjetër, duhet të jetë një konstatim shumë i saktë për këtë që merren ekspertë të ndryshëm, merren edhe gjyqtarët, ata që e gjykojnë rastin edhe i jatin atë emërtim. Ne në politikë me thanë duhet me i pasë argumentet e forta. Ali, besoj që komisioni i cili buron nga kuvendi që ju e keni zgjedh, plotsishtë pyetje me vend, i kërkojmë informata dhe e kanë obligim me e sjellë jo vetëm ata, nuk ka shërbyes publik civil, shërbyes profesional në shkollë dhe në mjekësi që kuvendi e ka obligim ligjor me ju përgjegj, këtë e kemi bisedu edhe me kryesuesin. Çfardo juve të ju intereson që vetëm nuk e prek konfidencialitetin, ju keni të drejtë me kërkën dhe kanë me sjellë, se është obligative edhe këta e kanë obligim me sjellë informatën si janë zhvillu procedurat. Liridonë, unë nuk e di bash në detaje krejtë me pru atë projektin, por me siguri ndoshta shumë më mirë është kanë ti me ju drejtu Zyrës së Projekteve dhe me shku individualisht me kqyrë çka të intereson, hiq nuk është problem ajo. Këto jan çështje të cilat kanë me qenë edhe publike, se detalisht tashti vetëm ingjinerat munden me ti tregu çka ka me u bë. Unë besoj që është ka punohet mirë, një kompani shumë e mirë, kur tham shumë mirë, kur them shumë e mirë, tybe ne ditsha, por po e shof që në dinamizëm po shkon mirë, por në çështjet tjera tashti varet se prej cilit sy e kqyrë. Te trafo, nuk është problemi vetëm në Drobesh, se edhe drejtori u përgjigji, ne kemi kërkesa të shumta. Unë besoj se, nuk ka kërkësë të cilën e bënë në adrës të asaj që komuna nuk është në gjendje me mbështet, por sa do të jetë ajo fuqia jonë e ndikimit që me të vërtet me i bë zgjidhje qytetarëve të Drobeshit. Po shkon pak rëndë, fillimishtë po të tregojë se, është mandati i tretë që e zhvillojmë, mandatin e parë nuk ka pas kërkësë të cilën e kemi bërë që e ka shtru kuvendi apo qytetarët e që se kan kryer, por kishin pas shumë do është të pazgjidhura dhe më duket që ajo ndikoj pozitivisht. Ne ja zgjidhshim çështjet, ata na i kryeshin tonat tashtë është tu na shku puna rëndë, a është mungesa e mjeteve të cilët nuk kanë ata në buxhet të parapamë apo veç me rëndësi është tu na shku rëndë. Sejd do të ishte mirë ajo është bazë e qytetërimit në rastë se arrim me i bë, por megjithatë nuk e di koston buxhetore sa do të jetë t'i ndoshta ke marrë ndonjë informacion më të plotë te zebrat që të vendosen edhe shenjat ndriquese dhe çështjen e gropave septike të cilën e percjell. Me te vërtet unë besoj se tashti kur do të jetë ajo, nuk guxoj të lidhem për afat, për shkak se është një kosot buxhetore shumë e madhe, por megjithatë konsideroj që tashti ka ardhë momenti që Komuna e Vitisë duhet të mendoj në këtë drejtim dhe me të vërtet mendon edhe për një impiant, se tashti ne si kemi marrë, krejt kanalizimet i kemi largu nga shtepitë tona i këna derdhë në lumë, prapë nuk kemi bërë një zgjidhje të mirë, por kjo është kanë si fazë e parë. Faza e dytë duhet të jetë kjo, një kërkësë kur kemi mundur me arritë edhe cilët do të arrihet, besojë që do të jetë suksesi më i madhë i asaj qeverie. Ti e dinë që ajo është kosto bukur e madhe, por megjithatë është nevojë imidiate që nuk mundet me i largu, edhe nuk ka derë që nuk e ka parashtu si kërkësë kryeatri këtë çështje, për shkak se krejt grumbullimi i këtyre dhe me një impiantë do të ishte pshtim edhe për natyrën, por edhe për qytetarët e komunës sonë. Faleminderit të gjithëve! Unë bëra përpjekje ashtu siç i kam shënu të kaloj gradualisht. E pash dhe rrugën “Hasan Prishina”, atë që kërkove ti është e parapamë me i mbush do gropë, që është në këtë kontratën në mirëmbajtjen e rrugëve verore, dimërore. Diçka tjetër nuk kam, marr informacion lidhurë me të.

**z. Taulant Haxhiu:** I nderuar i nënkyreatr, ne të zgjedhurit e popullit i bëjmë kërkësat këtu, sipas kërkësave të votuesve tanë të qytetarëve të cilët neve çdo ditë na tregojnë për hallet e tyre. Ti siç e vlerëson diskutimin secilit ato i bëjnë diskutimin në bazë të kërkësave. Unë po të shof ty, që kur këshilltari e bënë një kërkësë, ekzekutivi duhet me ia kthy edhe me kry kërkësen e një këshilltari komunal. Këshilltarët komunal bëjnë pyetje

per nevojat e qytetareve, kurse tи i thu ja e bere keshtu e keshtu, nuk kisha dashte. Secili qytetar i ka zgjedh keta në bazë të referencës së tyre. Nuk besoj që ti mundesh me ju tregu secilit këtu se si ai e perfaqëson veten. E dyta, që i the këshilltares sonë të nderume, mos e përmend keqmanagjimin. Dëgjo, rruga e Zhitisë është kjo, e kemi me foto. A është kjo keqpërdorim apo keqmenagjim, me fakte unë. Të gjithë që kemi ardh këtu, ne jemi në bashkëqeverisje, ne jemi zgjedh me jau kry problematikat qytetarëve tanë që na kanë besu neve. Tashti po dal te tjetra, te rruga "Hasan Prishtina", po thu nuk ndreqet, nuk bëhet ujësjellësi. A beson që ujësjellësi është aty gjëja më e rëndësishme e çdo qytetari. Edhe njëhere po e ceki, është lagija më e banushme në Komunë të Vitisë, e kemi edhe një inicim të trafes, ne duhet me bë përpjekje me pasë një trafë aty. A beson çfarë rryme është. I nderuari nënkyreatr, në qofte se unë sot e lëshoj nxemjen poshtë, naltë nuk kemi rrymë te shtëpia ime. Unë jam banori i asaj lagje, unë kam nevojë me pas një sqarim të saktë nga ekzekutivi apo nga bashkëpuntori im i kualicionit, që qytetarëve me ja u dhanë një sygjerim. Ti po thu nuk bëhet deri 2023, nuk po ma jep një sqarim konkret, unë duhet me ditë, ata kanë kërkesa, kanë nevoja. A beson që rryma më e dobët në Komunën e Vitisë për shkak të trafos është aty i nderuari Aliu. Është e vërtet që si çdo qytetar i Komunës së Vitisë duhet me dhanë kontributin, por beso që aty kemi shumë vizitor, çdo kush që ja mësyn Vitisë shkon në atë pjesë, për shkak se komplet restaurantet 4 - 5 që i ka Vitia i ka në atë pjesë. Me shku një qytetar i Gjilanit, Prishtinës ha ushqim të mirë edhe pasqyra kryesore po ti shof bërllogjet aty. Është mirë që ne po dojmë me investu si vend turistik, është mirë që të kemi më shumë vëmendje. Faleminderit z.drejtor për sinqeritetin dhe atë problematikë që e ka komuna e Vitisë e thave në mënyrën më të mirë të mundshme.

**z.Ali Bajrami:** Faleminderit kryesues! Nënkyetar, po pres në seancën e radhës me na ardh informata edhe njoftimi rreth ankandeve që janë bërë. Për mua është e pakuptimt me u dhënë prona komunale. Drejtoritë përkatese që i menaxhojnë ato hapësira, objekte mos me kanë të njoftum edhe mos me ditë në këtë seancë, është pa përgjegjsi totale. Unë i kam, por po dua zyrtarisht me u njoftu, nuk po du unë me i bë publike se, nuk jam unë zyrtar, prandaj fjalën që e the ti, po e pres në seancën e radhës me na ardh zyrtarisht informata. Pse po e themë këtë, kryetarët e asnjërit komision nuk janë prezent në seancë. Është dashtë me qenë. Edhe tjetra, rreth rrugës "Hasan Prishtina". Në seancën e kaluar që e kam bërë pyetjen, segmenti i asaj rrugës, gjatësia është 170 metra që ka mbetë pa u asfaltu. Faleminderit!

**z.Nexhat Halili:** Unë po vërej se po anashkalohen pyetjet të cilat po adresohen nga anëtarët e kuvendit. Nënkyreatr, nëse vlerat e planifikuara tejkalohen atëherë në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, neni 7 nëse nuk gaboj, planifikimi i prokurimit nëse tejkalohet atëherë autoriteti kontraktues është i obligum nëse tejkalohet vlera substanciale të anuloj atë procedurë të prokurimit dhe të fillojë në një procedurë të re, që në këtë rast ju nuk e keni bërë këtë, mirëpo përgjigjet për sa i përket buxhetit, besoj se i jep drejtori i buxhetit. Më mirë ndoshta është më i informum se sa ne. Faleminderit!

**z.Hasan Aliu, nënkyetar I komunës:** Nuk po dua, por të njëjtën çështje je tu e shtru vazhdimisht. Domethanë e bëre një vjet, dhe në rastë se ke konkrete Nexhat, mos më keqkupto, e paske këtu përgjegjësin e Zyrës së Prokurimit. Do të ishte shumë më mirë, në çdo seancë në rastë se kërkoni detajet të kërkohen me ardh sikur që do t'i sjelli inxhinierat, Zyrën e Prokurimit dhe pyet detalisht pse nuk e ke anulu, pse e ke bë, pse nuk e ke bërë. Gjithsecili është përgjegjës për atë pjesën e vetë.

**z.Nexhat Halili:** Sa kanë të drejtë këta të marrin pjesë? Nëse policia nuk kan të drejtë, pse këta kanë?

**z.Hasan Aliu, nënkyetar I komunës:** Po këta janë puntorët tanë, policia është diçka tjetër. Është problematikë Nexhat me bisedu me ty, unë e kam shumë telashe se, ende nuk e bënë ti dallimin e punëtorëve të komunës edhe të policisë. Kur ta bëjshë ti këtë dallim, atëherë nuk është shumë problematikë kjo çështje. Taulant, ti qysh dash merre, se unë po të shofë që përdor një fjalor. Një çështje ta kesh të kjartë, në jetën time gjithçka çka kam bërë e kam bërë me dije, nuk ma ka bërë kurr askush, me dijen time e kam bërë. E kuptoj edhe çka është këshilltari komunal, e kuptoj edhe të zgjedhurit e popullit, tu fillu edhe te këshilltarët, edhe deputetin e kuptoj edhe pozitën e nënkyetarit edhe të gjithëve. Megjithatë, unë nuk deshta me ju hup kohë, por kërkesat të cilat i

merr, asnjë kërkesë nuk eshte me injoru. Veç i keshilltarë i kuvendit komunal duhet me i ditë perqjegjesitë e veta dhe cilat kërkesa i merr dhe cilat i shtron. Me zanë unë me të shtru nga pozita ime kërkesa të qytetarëve, me u nise prej Remnikit me ardhë deri në Viti edhe 10 vite nuk mundet me i kryj komuna, prandaj këshilltarë i kuvendit komunal, ai i cili e ka ngritë dorën, në veçanti ti që ke qenë edhe në mandatin e kalum të buxhetit, gjithëhere kërkesat i bënë konfrom atij buxheti, i cili është i parapam. Ligji ka thënë, nuk ka thënë Hasani, këtë duhet me pas të kuart, dhe në rastë se ti a cili do khilltarë e përdorë terminologjinë, keqpërdorim, duhet me pas një thes argumente, duhet me qenë puna e përfundume, duhet me qenë komisioni i pranum teknikisht dhe tanë del me këtë në situatë normale. Kur thuhet keqpërdorim i buxhetit komunal, që decidivisht e ka thënë në këtë formë, dhe në një shtet të cilit i funksionon ligji, momentin kur të dalsh prej seancës të vjen prokuroria edhe të thirrë në intervistë dhe të thotë, khilltarë e ke ngritë një çështje të cilën ke thënë keqpërdorim, cilët janë keqpërdoruesit e kësaj çështje, në këtë drejtim unë thashë, se besoj që kam të drejtë. Në rastë se nuk kam të drejtë nuk hi në sallë të kuvendit kurrë, këto janë të drejtat të cilat po ti themë, të cilat duhet mi ditë çdo khilltar i kuvendit komunal. Dhënia e një emërtimi, duhet me pas argumentin me vete dhe në këtë drejtim as nuk thashë që është e mirë. Nuk themë unë, duhet me thanë njerëzit profesional. Në këtë çështje e shtrova unë. Nuk mundem me thanë Taulant që, ujë ki me pasë në rrugen "Hasan Prishtina". A e din pse, se nuk më kanë thanë që ka me pas. E din edhe ti se, kapaciteti i fabrikës "Letnicës", tash momentalisht është 40 litra për sekond, dhe e din të hala më mirë se unë se je në qytet që je lindë edhe je rritë, që nuk mundet me furnizu këtë. Unë dua edhe mas kryerjes së mandatit mos me më thanë dikush na mashtroj. Jo nuk mundet deri sa nuk bëhet një zgjidhje, një rritje e kapacitetit të ujut apo një alternativë tjetër. Gjendja është kjo, në rast se ti donë veq me të maru qef, nuk mundem, gjëje një tjetër.

**z.Taulant Haxhiu:** I nderuari kryesues, unë po e shof që këtu është keqmenaxhim, rruga është shtru, ne po ti ekzekutomi faktet, kjo po ti tregon faktet që kështu është rruga, kjo ka obligim me të tregu që nuk është tu punu mirë, ti je nënkyetar komune, khilltarët komunal 1 herë në muaj e kanë mundësinë me u kanë para ekzekutivit, ata mrena mujit i mbledhin të gjitha problematikat e komunës vet dhe i diskutojnë në Kuvendin Komunal të Vitisë. Unë po e dij që, ujësjellësi ka kapacitet të vogël, por ne duhet me u bë zgjidhje qytetarëve. Zgjidhja jote ke, nuk dijë. Çka bëhet është mirë se është vendi më i banuar në Komunën e Vitisë. Ti po thu nuk bëhet, nuk ka kurgja, të gjithë që jemi pjesë e këtij kuvendi të gjithë kemi edhe referanca të tjera, të gjithë kemi ardh me dije, se për budall nuk është kuvendi, njerzit me dije kanë ardh këtu. Unë nuk e di që ka, a ka dikush që është budall këtu, a qështu deshtë me thanë. Unë po të respektoj, por injorimin që po u ja bënë khilltarëve nuk po më pëlqen. Qe 20 vjet je në kuvend, duhesh me respektu këshilltarin e ri.

**z.Basri Aliu, drejtor:** Edhe unë po i drejtona si zotri Haxhiu, se kështu po na drejtohet Taulanti, dhe më vjen mirë Taulant që bile një drejtor e livdove. Nganjëhere po i perzim kompetencat ose nuk po doni me i kuptu qëllimi apo nganjëhere edhe prej mos dijës. Përshebull te rryma. Ne themë që nuk është kompetencë e komunës, inicimi niset edhe prej qytetarëve, inicimi ka nis çdo here, ti e din çka flet, por ndëgjo, është KEDS që mirret me këtë punë, ne jemi vetëm me ndihmu në këtë drejtim. Në këtë mënyrë ju mundeni me shku te KEDS-i me bisedu, je këshilltar, po thu jam i zgjedhuri i popullit, e atëhere shko edhe atje. Unë kam bisedu me drejtorin, nuk kanë mundësi ata, nuk kanë investime, për ata jam i gatshëm. Edhe te biznesi mos të hudhin mbeturina aty ku nuk është vendi.

**z.Taulant Haxhiu:** Ti duhesh me marrë masa i pari. Edhe njëherë, zona e Letnices dhe e Stublles është një zonë turistike, po ka vizitorë më shumë të jashtëm. Më kanë bërë vërejtje për të, unë ta shpreha si shqetësim. Edhe te trafo, ti këtu po i përzin gjérat, unë thashë kemi problem me rrymë, është mirë me iniciu. Ndryshe është kur shkon te KEDS-i nënkyreatri i komunës ose kryeatri i komunës për një problematikë, ndryshe kur të shkoj unë.

**z.Nexhat Halili:** Unë po vrej që pyetje që bëhen khilltarët strukturave udhëheqëse nuk po ju pelqejn. Nuk e di pse ne e kemi për detyrë të bëjmë pyetje, këta të kthejnë përgjegje aspakt. Unë nuk kam me nënkyetarin

personalisht, mirpo shprehja e tij qe nuk mund te komunikoj me ty nuk po mundem me kuptu, jane gjera qe ne i bëjmë pyetjet ju i ktheni përgjegjet. Unë po e shofë që po anashkalohen pyetjet, jo një por shumë.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar I komunës:** Dëgjo, te një çështje Nexhat, pse po bjenë në këtë nivel. Po ta përseris edhe njëhere, në rast se këtë e konteston ti unë nuk e di çka me ndermarr dhe çka me të bë ty. Gjitha pyetjet të cilët i keni në adrës të puntoreve komunës mundem me i sjell këtu edhe informatën edhe ata drejt për drejt me ta dhene përgjigjen ti më the qysh po i sjell puntoret e policinë nuk po mundesh e këtu Nexhat unë sun bisedojë me ty edhe në këtë drejtim unë thashë policinë nuk mundem ne mundemi me kërkua por ata nuk e kanë për obligim me ardhë kuvnedit me i dhanë informacion lidhur me krimin në komunën e Vitis.

**z.Nexhat Halili:** Unë veq bërë pyetje pse nuk mundesh me i sjell mirpo unë po deklarojë që pyetjet po i anashkaloni edhe po të tregojë ndesh konkretishtë me pyetje.

**z.Fadil Abazi, Drejtori:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit , lidhur me tejkalin e planifikimeve të cilat po i përmend Nexhati nuk ka ndonjë nen i cili eksplicitë thotë se duhet por do të thotë mundet prandaj në 3 raste e permende rastin nëse tejkalohet vlera e planifikuar e buxhetit është nen 7 thotë substancialishtë nen 62 pika 1.2 thotë mundet mirpo krejt mbetet në autoritet se si vendosë autoriteti për atë në deklaratën e nevojave mbasë shpalljes së procedurës nëse tejkalohet buxheti është pika e fundit 3.4 e cila thotë arsyeto nëse ke tejkalu prandaj në kemi dokumentacion rreth tyre i kemi të evidentume qdo kush që është i intersum mundë të vijë dhe ti i marrë aty i ke edhe arsyetimet pëershakak të tregut sivjet që ka qenë i qrregullt ne kemi bërë gjatë lidhjes kontratave unë kam bërë edhe hulumtim të tregut i kam marrë ofertat të cilat kam mëndu që janë jashtë qmiemeve të tregut kam bërë hulumtim dhe kam marrë një vendim ne kemi shum qmime të cilat kan luajtur në mënyr enorme prandaj planifikimet kan qenë të më hershme ku planifikimet nuk i kemi parapa ne që do të ket rritje të qmiemeve mirpo është argumentimi i tyre dhe ligji në asnjë moment nuk thotë ndalohet thotë mund të ndalet kjo mundë ta jep mundësin që ti nëse ki një zgjidhje e bënë nëse nuk ke zgjidhje vazhdo në anulim domethen në 3 rastë permendet qështja e planifikimit buxhetit.

**z.Nexhat Halili:** Është e vërtet që në Ligj të Prokurimit thotë substancialisht. Nëse merrni e krahasoni rrugën Sllatinë Viti, nëse e merrni e parashini kontraten e lidhur me 2021 me 224 mijë euro e në vitin 2022 kontraten e 2021 e keni anulu vetëm me pikën e çmimeve, por e keni anulu se keni pas edhe devijime në projekt, tashti kontrata e re e cila është lidh është dikun 544 mijë e diçka, që është një vlerë kogjo e madhe, që tejkalon planifikimin. Nëse ështe vlerë tepër e madhe, e tejkalonë planifikimin, atëherë duhet të anulohet ajo procedurë sepse duhet nderlidhesh me Zyrën e Buxhetit. Nëse Zyra e Buxhetit nuk ka mjete ku i merr ato pare. E dyta, nëse ka pas ndryshime të çmimeve për rrugën Sllatinë-Viti, pse nuk pat ndryshime në rrugen e Mjakut. Është vazhdu, pas një Viti është nënshkru kontrata. Faleminderit!

**z.Fadil Abazi, drejtori:** Nexhati vërtet po i jep disa konkludime, mirëpo ato nuk janë të bazume. Ky po konludon pa e përdor argumentin, ndërsa e ngritë si hipotezë punën e Sllatinës. Nuk ka ardhë me marrë të vërteten tek ne. E vërteta është pak më ndryshe se si po e thotë ky. Është e vërtet që kontrata ka qenë e tillë, mirëpo ne kur e kemi rishpall kemi bërë edhe rritjen e paramasës jo vetëm të çmimeve, kemi rrit paramasën me kontraten që e kemi anulu. Ka qenë 4.90 asfalti, sot është 12 për centimetër, domethanë është dikunë 120%, edhe nuk është tejkalu me ato vlera që i përmend ky, sepse planifikimi i rishpalljes nuk është 240 mijë por është 500 mijë, dikun domethënë është për 44 mijë ndryshimi, prandaj ky duke i përdor disa shënimë edhe tu i bë disa krahasime të paqëndrushme dhe vjen në një konkluzion të tillë thuja se ka bë një shkelje që nuk është e vërtet dhe nuk është e qëndrueshme, ndërsa ky e din mirë se ka punu në prokurim, shumë mirë i njef gjërat, mirëpo problemi i tij është që, prej një profesionisti kur është shndërru në politikan po e përdorë fjalorin politik. Ky nuk ka nevojë me kallxu me thanë që duhet me marr prej buxhetit informatën, kur e dinë se pa deklaratë të nevojave rreth shumës së planifikuar nuk mundesh me shpallë hiq, prandaj këto janë si hipoteza që po i ngritë ky edhe po jep njëfarë mendimi sikur diçka është keqpërdor aty. Nuk është keqpërdor asgjë, gjithçka është në rregull. Unë e ftoj me ardhë aty me i shiku letrat, i kemi krejtë të argumentume. Faleminderit!

**z.Nexhat Halili:** I huqi edhe çmimet, se çmimet e astaltit ne vitin 2021 kane qene 5.5, kurse kete vit eshte 10.80, e njëjtë kontratë. Unë e pata në atë që është anulu një kontratë ka fillu një kontratë e re, pse nuk u anulun edhe kontratat tjera, pse kontratat tjera shkun me çmime të vitit 2021, a nuk ka pas inflacion edhe për kontratat tjera apo ka pas inflacion vetëm per këtë kontratë, edhe anumalia tjetër çka është, kompania e njejtë që ka qenë 2021 e njëjtë e ka marrë edhe 2022 edhe eliminohet operatori që ka pas çmim më të lirë.

**z.Fadil Abazi, drejtori:** Ky prap po përdor gjërat që krahason dhe të cilat nuk janë të qendrushme, sepse ato që po i krahason ky nuk krahasohen. Nuk mundesh me i përdor si argument krahasues, prandaj po shihet një subjektivizëm i caktuar tendencioz për me abuzu me informacionin, që një informacion ky mund ta ketë po nuk po donë me pas, mundet ma ardh çështja e Mjakut dhe e Sllatinës, janë dy të ndryshme, sepse ne edhe qeveria ka dhanë udhëzime, prishni kontratat në të cilat kanë deviju çmimi. Operatorët ekonomik nuk janë të intersum me vazhdu. Të paren here ne e ftojmë operatorin ekonomik që ai të deklarohet rreth kontratave, sepse kontrata të cilat jan nënshkruar më herët, të gjitha përshkak çmimeve kanë pësu ndryshime operatoret ekonomik. Në Mjak e kam qu kërkesën, ju kam thënë kështu, a jeni të interesum me vazhdu apo me nënshkru, ai e ka nënshkru kontratën. Tashti ëshhtë problemi i tij krejt personal, është punë e tij, sepse nashta ai ka me qit shumë zall, e ka zallin e vet e nuk e llogarit hiq atë punë. Ne e kemi për detyrë në bazë të udhëzimit që ka dhënë qeveria, me i ftu operatorët, me ju dorëzu kërksa edhe me ju ofru atyre një lloj marrëveshje për shkëputje, për shkak të çmimit të tregut. Nëse ndonjë operator është interesu për me shkëput e tjetri jo, atëherë komuna është aut, sepse ne nuk kemi kurrfarë përgjegjësie për këtë punë, ndërsa te kjo tjetra që e ka marrë po i njëjtë, ajo është krejt rastësi. Ofertat jan të hapura, kontratat janë të hapura, prandaj ushtrimi i ndikimit ose bërrja e diçkaje rreth supozimit që po mendohet, nuk ka asgjë të vërtet.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Ki rrugë intolucionale për çdo paqartësi, për çdo mendim që mendon janë tejkalu kompetencat e Zyrës së Prokurimit e zyreve tjera.

**z.Musli Neziri:** Faleminderit kryesues! Nënkyetar, kesh tu të mbet borgj për replikën. Edhe unë kam qef me respektu njerin tu fol, nuk dashta me të ndërhy atëherë kur fole. Fole për fshatin Ballancë dhe me the janë tu punu disa punë. Po ta bëjë një pyetje direkte: a je kanë ti me i pa se çfarë pune janë duke u bërë. Me një far forme po na drejtohesh, sepse morre bollë kritika prej këshilltarëve, se nuk mundesh me i ndal me i msu këshilltarët se si me ta bë pyetjen, prandaj nëse ti donë me u mbajtë për fjale, aman edhe një here mbajem për fjale. Thashë, nuk duhet për dikan të jetë nanë e per dikan njerkë. Pse po e themë këtë, sepse si e arsyeton ti që, nëse një shtëpi ju shrohet asfalt tjetrës shtëpi 10 metra janë rrugët ner mjet. Nëse flet për këshill të fshatit, asnjëherë, sepse unë kam dhanë dorëheqje nga këshilli i fshatit, asnjëherë nuk janë përfill këshillat e fshatrave. A po donë me ti tregu kërkesat e fshatit Ballancë se si janë kanë të orjetume, janë kanë që të asfaltohen të gjitha rrugët. Kurr prioritet nuk ju keni dhanë dhe kurrë nuk na kanë thirrë me shtru njérën apo tjetrën, tashtë po të flasë për Këshill të Fshatit Ballancë meqenëse po diskutojmë për Ballancë. Fole, po donë me u mbajtë për fjale, nuk bënë me thënë kështu. Po ta them edhe ty se, nuk jam ekspert me vlersu trotuarin, nuk vyn ekspert me vlerësu trotuarin Zhiti-Ballancë, vyn sy me pa që nuk është mirë, prandaj tu kisha lutë nënkyreatr, nëse donë me fol veç mi injoru pyetjet, me i injoru per gjigjet, nuk është problem, unë e kam në natyrën time, përndryshe nëse dojmë me bë debat qysh po donë ti, ki drejt me fol ti nuk i drejtë me folë, është mirë, e kam një odë atje te unë, hajde diskutojmë, ti e jep fjalën ti e merr fjalën. Mos bëj hajgare me këshilltarë. Unë kërkova që në fshatin Ballancë rrugët të cilat janë parapa edhe nëse që kryeatri është ardhë e ka bë porurimin e rrugëve, merre kqyre me 17 totor e ki në web faqe të komunës, nuk e shkrju statusin e faqes komunës unë, merre kqyre cilat rrugë janë cek që kanë me u shtru asfalt, dhe hajde sot shkojmë i kqyrem cilat janë tu punu. Prandaj nënkyetar, thave duhet me pas argument me folë. Asnjëherë qe 1 vit që jam këshilltar këtu nuk flasë pa argument, asnjëherë. Nuk dua askënd ta atakoj dhe ta akuzoj për një punë që nuk është, nuk kam bërë akuzë, por nëse kërkojmë një përgjegjësi këshilltarëve, një adresë ose një kërkesë të qytetarëve duhet trajtohen të barabartë. Ti the po të mbaj prap për fjale, sepse po donë me u mbajte per fjale me neve, prapë po të mbajmë edhe ne juve. The me u nis sa pyetjet i marri ndoshta jeni msu me

titu me dure ne gjepa, sepse kemi pas deklarate prej lidereve politike qe qytetari nuk vendos, por qytetari vendos, prandaj jemi te zgjedhur te gjithë, kemi te gjithë te drejtë me fol mendmin dhe mundohu me respektu secilin në pyetjen që e drejton. Prandaj nëse nuk ki informata, mundesh me thanë nuk kam informatë, në te merret dikush tjetër, por unë po te lutna kqyre 17 tetorin në faqen e komunës çka keni postu për fshatin Ballancë dhe hajde shkojmë, kqyrem çka është tu punu. Besoj që e kuptove edhe mesazhin pas asaj fjalisë nanë e njerkë, dhe tu kisha lut mos ju drejto këshilltarëve kurrë, është ingjizimi e nuk është ingjizimi, sepse edhe për ty është ingjizimi se çka ke folë dhe për secilin këtu është ingjizimi. Prandaj, nuk është e mirë kjo. Faleminderit!

**z.Hasan Aliu, nënkyetar I komunës:** Kshilltarë i kuvendit komunal, po ta përsëris sërisht se, nuk e kam ndërmend te ndryshoj pas 60 viteve dhe pas 30 viteve në politikë, këtë duhesht me pas te kuartë në një, dhe e dyta, në rast se ty tu ka dokë që shumë bukur e ke thanë për dikan nanë e për dikan njerkë, mua më është dokë shumë keq, se ke bërë një dallim. E treta, ato rrugë te cilat janë tu asfaltu, tu rregullu, janë edhe në mesin e propozimeve të atyre shumë rrugëve. Ta kam thënë edhe po ta përsëris, nuk keni lind për një ditë dhe nuk kryhen krejt për një ditë. Nuk ka përgjigje më te mirë. Me pas buxhetin shumë të lartë, shumë më mirë do te ishte me kry krejt përnjëhere. Në rast se dy janë edhe ato janë në mesin e atyre rrugëve të cilat i keni kërkua. A ke dhanë dorëheqje apo nuk ke dhanë, nuk jam marrë me atë se është problematikë e jotja një, kurse e dyta, nuk te kam mësu por ndoshta ka nevojë edhe me te mësu se, nanë e njerkë ti po e bënë një dallim. Një ashtu e ke thanë sikur kualicon, qeshtu e ke thënë.

**z.Musli Neziri:** Jo nuk e kam thënë ashtu. Thashë është mesazhë për kualicione qeverisës.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar I komunës:** Edhe kjo në rastë se ti është mesazh për koalicionin qeverisës, ne zyrat i kemi i nderum, e një kryesues e ki, disa përfaqshues, edhet ti aty mundesh me ardhë me i bisedu, nuk ka mbet me ardhë ti me më thanë mu në kuvend.

**z.Musli Neziri:** Nënkyetar, prapë mos mu drejto me ti me drejtu çka kërkoi unë, tu kisha lutë. A te pëlqen a nuk te pëlqen çka e flasë, unë nuk vijë me te vetë ty, po tu kisha lutë mu mos mu drejto ti e pate mirë se pate mirë, sepse unë e thamë ata çka du me mëndu dhe mendoj me mendimin tem. Mos u mundo me i injoru këshilltarët, sepse edhe ti po vërehesh, po vrehesh që me dije e pa dije po i permend këtu te dyat. Dëgjo, për dije e pa dije jemi secili këtu, ata e kanë vlerësu dikush tjetër dije kemi te gjithë. Unë po te thamë edhe njëhere, mos u mbaj shumë përfjale e the se the, kjo në te jetë një mesazh edhe ty ndoshta nuk te pëlqen qka jam tu thanë, po as mu hiq ajo e jotja.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar I komunës:** Në rast se nuk te pëlqen kjo që po te themë, kurr mos pyet pse po pyet ti. Edhe po më pyet edhe po thu nuk po më pëlqen.

**z.Musli Neziri:** Thjeshtë, te ish kan kryeatri i komunës i kisha bë pyetje atij nuk te kisha bë ty, prandaj në pozitën që e ki po duhet me ti drejtu pyetje dhe po mendoj që është respekt që po ti bëjë pyetjet apo hajde këtu thuaj mos bëni pyetje dhe ne nuk po bëjmë.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar I komunës:** Një çështje po ta themë, është viti i 9-të, nuk ka kshilltarë te kuvendit komunal që e ka bërë pyetjen e që Hasan Aliu nuk e ka shkru kur kam qenë unë përgjegjes për atë çështje. Nuk është që nuk kam bërë përpjekje me kthy përgjegje kurr në jetën time gjatë diskutimit tim pyetje dhe përgjegjje që kam dalë përjasht dhe që i kam injoru.

**z.Musli Neziri:** Nënkyetar, në seancën e kaluar te kam falenderu për atë që mundohesh me i dhanë pyetjet. Kam dhanë kritikë për drejtorët, ti e dinë këtë mirë, por në mënyrat e injorimit te përgjigjeve nënkyetar, kjo është shqetësuese për neve këtu e pata.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar I komunës:** Unë po mendoj që profesor je dhe ti këtë model e dinë që, kur ta pyesësh nxënësin a ke dhënë gabim a e ka dhënë te saktë, duhesht me degju deri në fund mendimin e tij, dhe unë besoj që duhet me pas një konsideratë edhe për pozitën edhe vjeterësinë me lanë ta mbylli edhe ty nuk te pëlqen nuk te pëlqen, nuk kemi qka bisedojmë. Me këtë deshta me te thanë, kurr nuk te kam injoru qysh dush merri, por megjithatë mua personalisht nuk më erdh mirë edhe kur dush ta argumentojë, ndash hajde në zyrë që nuk është

kane. A do ti me u terhek apo nuk done, eshte çeshtja e jote. Une nuk jam tu thane terheku, por megjithate nuk është mirë në rastë se ti kogjo mirë që e ki mandatin e parë, por ndoshta ke marrë ke lexu në partnerin e kualicionit shtron edhe thu se, kur ti thuash dikujtë dikan nanë e dikan njerkë, menjëhere shtrohet dilema, në këtë kontest e thashë dhe do ta them përsëri se, nuk është e mirë për partnerin e kualicionit me thanë atë çeshtje. Në rastë se ty të doket mirë ti vazhdoje, por e mirë nuk është.

**z.Musli Neziri:** Besoj që edhe pozitën e profesorit e kam marrë me dije. Meqense e permende dijen këtu. Edhe këshilltarin komunal pozita parë kofsha dikush e ka pasë për herë të parë, secili e ka pasë nga një fillim, edhe ti që je qe 9 vite e ke pasë një fillim dhe qytetarët kanë vlersu, por mesazhi im prapë po ta përmendi nanë dhe njerkë, dhe nëse nuk donë me u bind me këtë a të pëlqen a nuk të pëlqen, prapë nuk e kam dertë atë, shkojmë vizitojmë kaq. Faleminderit!

**z.Jakup Demiri:** Në këtë seancë përveç përgjigjeve që i murrem për pyetjet që i parashtrum ishin ato të KPF-së, ndërsa të tjerat shumica e pyetjeve këtu nuk murrën përgjigje. Unë kisha propozu që në muajin Dhjetor kjo pika e projekteve që i kemi investime kapitale të bëhet pikë e rendit të ditës dhe të diskutojmë si pikë të rendit ditës. Kishte me qenë mirë me i thirrë edhe inxhinierat, edhe ata çka janë përgjegjës nëpër komisione pranuese edhe menaxherat e projekteve me të cilët mundemi me bisedu, ndërsa pak po lidhna te uji i pijshem që po e thojnë këtu në komunë, por unë kisha thanë sinqerisht që, Komuna e Vitisë qytetarëve duhet t'ju kërkoj falje për punën e ujit të pjes, për shkak se vitin e kaluar i kemi pas dikun 70% të fshtatrave të lagjeve, qytetit me ujë të pjes, kemi edhe ingjizime edhe video që kemi ujë të pjes edhe Komuna e Vitisë mbi 70% e ka kryer problemi e ujit të pjes dhe ne e dimë që në fakt se si qëndron puna me ujin e pjes në komunën tonë dhe si ka qendru dhe sa e kanë pas prioritet ujin e pjes komuna jonë, ndërsa Komuna e Vitisë për shkak të ujit pjes është kampion me smundjen e veshkave në nivel vendi. Për këtë kisha thanë ose me u skjaru ose me ju kërku falje qytetarëve se vitin e kalum i kemi pasë diku 70% të banorëve me ujë të pjes e që ajo është kanë me ba hajgare me qytetarët. Më vjen keq që e thamë, por jemi pjesë e saj që e kemi përfjetu. Edhe te drejtori Aliu për punën e ndriçimit publik. Mirë është edhe me infromu qytetarin, edhe unë përmes telefonit kur i shohim por po i shohim për ditë edhe po i shohim që nga muaji Shkurt i vitit kalum drejtor, e kam tërhek këtë vërejtje shumë here për ndriçimin publik. Tashti nuk e di, nuk po bini që dikush është nxanë me emër dhe mbiemër, jo publikisht, po të paktën unë me ditë se e kam bërë këtë pytje 10 here, sepse ndriçimi publik paguhet prej taksave tona, dhe pikërisht prej tatimit në pronë që e pagujë dhe prej atij fondi shkojnë që pagujmë ndriçimin publik, kogjo po na kushton. Edhe si është puna me energji elektrike, nuk po e shofë që është përgjigje jo e singertë, por jo boll serioz se për e singertë po të besojë dhe nuk është marrë ky problem serioz në komunën tonë. Po flas se, e kemi tërhek vërejtjen vazhdimisht për ndriçimin publik që funksionon ditën, por nuk e di që ka pas ndonjë intervenim. Faleminderit!

**z.Basri Aliu, drejtor:** Jakup, më duket kemi bisedu edhe bashkë, të kamë thanë çdo here kur është ndriçimi dhezë ditën, është mirë me na informu, mos me prit kuvendin, sepse zgjatë 1 muj ditë. Ne në teren nuk mundemi me qenë çdo here, por unë thashë po ndërhyn ne po e rregullojmë, po ndërhyn edhe qytetarët edhe operatorët të cilët i kan kablovikat. Kështu që po mbesin ato dhezë.

**z.Jakup Demiri:** Nuk e kem pas as për me bë politikë, sepse kemi komuniku për këtë punë. Po mu dashtë me ngritë si çeshtje pak më të madhe këtu, nuk e kam personale me askend, se fundi i fundit nuk është në gjepin as ndonjë dobie tjetër, por me të vërtet është bërë problematike dhe e kam bërë për masa. Fillimi isht e kam parë në fshtin tim, aty, mandej e kam parë edhe në qytet në Viti, tregova edhe lokacionin.

**z.Basri Aliu, drejtor:** Po në qytet në Viti ka ndodhë, por thashë unë që, operatori ekonomik deri sa punon me ditë ku është defekti ata i dhezin dritat, se në Viti jam vet këtu, mundem me i përcjell dhe ndërhym, por deri sa të punon ai duhet me i gjetë defektet, atëherë edhe dritat duhet me u dhezë me ditë se ku është defekti.

**z.Nexhat Halili:** Unë vec po du një koment të vogël këtu, nëse këtu procedurat e prokurimit janë të publikume në prokurimin elektrik dhe janë të publikume gabim, atëherë më falni, mirëpo unë i kam marr këto dokumente ku jan të publikume në webfaqen e prokurimit publik. Nëse i kanë publiku gabim, atëherë paska qenë gabim.

## R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e rregullt e KK-së.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores me Nr.01-110/05-1057, të datës 29.09.2022 për taksa, ngarkesa dhe gjoba.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2022-2026.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për krijimin e kodeve të ri për projekte me perticipim.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në konsultim publik të draft Rregullore për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar I komunës:** Nga Zyra e Prokurimit dhe nga Zyra e Projekteve ka ardhë edhe një propozim vendim, që ndoshta duhet të ju kërkojë falje për shkak që nuk e kanë pruar në kohë, ndoshta në pamundësi që e kanë pas është propozim vendim për Planin Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë 2022-2030. Aspekti ligjor e kërkon që kjo sot të hynë në rend dite, ta zëmë afatin kohor në relacion dhe unë besoj se, do ta ketë mirëkuptimin e këshilltarëve komunal. Është edhe zyratri këtu që e ka përgatit edhe arsyeshmërinë e saj, Xhelal Musa, që do ta ketë fjalën më vonë, por megjithatë ne kemi bërë përpjekje së paku kryetarëve të grupeve të ja u japim nga një plan ta kenë, në pamundësi të shumzohet se ka ardhë nja I orë para se me ardhë në seancë.

**znj.Liridona Bislimi:** Nënkyetar, po besoj që kemi pas raste të tilla të ngjashme shumë shpesh dhe gjatë mandantit të kaluar edhe gjatë këtij mandati edhe ndoshta kjo është një praktikë që është shndërru prej Komunës së Vitisë edhe nuk e di a është tu ndodhë njejtë në komuna tjera, por unë e kam ngritë këtë edhe si shqetësim në diskutim që e kam pas me një përfaqshues prej MAPL-së edhe kjo nuk është një e drejtë, kjo është një diçka e padrejtë që po na ofrohet neve si këshilltarë komunal. Nëse tu ofrohet një dokument aty per aty për me kalu në diskutim, ne duhet me pas hapësirë për me vlerësu për me u konsultu, për me bë një analizë për atë dokument që është duke na u sjellë, edhe mendoj që, kjo praktikë duhet me fillu me u ndalë, me u stagnu edhe me trajtu me seriozitet, përshkak se ne si këshilltar komunal në momentin që tashti po na ofrohet ky dokument. Ne mundemi ndoshta edhe me votu, por nuk e kemi informacionin e qasshëm edhe nëse e kemi informacionin ne nuk kemi pas hapësirë për me bë një analizë më të specifikume, kështu që, kisha kërkua prej juve me u sjellë më serioz në këtë pjesë në këtë qasje edhe mundësish me ndalu. Faleminderit!

**z.Hasan Aliu, nënkyetar I komunës:** Plotsisht pajtohem, jam për atë që të vjen materiali në kohë, por megjithatë gjithëhere unë themë se, Vitia nuk është as e pozitës as e opozitës, është e të gjithëve, prandaj kanihere njeri duhet me flakë uniformen edhe mendimin e vetë për një çështje që është më madhore për qytetarët tanë, pikerishtë për këtë unë kërkova mirëkuptimin e juaj.

**z.Ali Bajrami:** Kryesues, për shkak të procedurave dhe për shkak të afateve ligjore kuptojë që është sjellë para seancës por pikerishtë atë që e tha edhe nënkyreatri mos me hupë afatin mos me hupë atë që janë në të miren e qytetarëve dhe Komunës së Vitisë. Ne si grup parlamentar do ta përkrahim dhe do ta votojmë këtë ndryshim të renditë të ditës dhe të futet si pikë e rendit të ditës.

**z.Remzi Salihu:** Faleminderit kryesues! Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Tashti po diskutojmë për rendin e ditës të cilin ende nuk e kemi miratuar dhe na është sjellë edhe një pikë e rendit të ditës, për të cilën unë mendoj që ka qenë dashtë që kjo të diskutohet më herët. Arsyetimi është bërë se ta zëmë afatin ligjor që të jemi konform ligjit, mirëpo siç e tha edhe bashkëpartiakja ime, shumë herë keni sjellë kërkesa të tilla, prandaj unë mendoj që, përderisa ne nuk e kemi shqyrtu materialin, mendoj që është kohë e shkurt ta shqyrtojmë atë material dhe ne kur të vendosmi për të votuar diçka duhet ta dimë se çka të votojmë. Një shembull të tillë po u a ja me të cilin kam qenë edhe atëherit kritikë, ka qenë zënja e afatit ligjor për ndërtimin e një shtëpie për persona me të meta mendore apo fizike, e llojit të tillë që e kemi caktu te shtëpia e shëndetit, që sot e atë ditë nuk dimë me atë projekt se çfarë është bërë. Ne kemi votu që ta zëmë afatin ligjor që të përfitojmë nga ajo që është kanë, por nuk

e dëme se çka eshte bere edhe e kemi votu te njejtin pike te rendit dites ateherit si kjo qe na ka ardhë sot. Une mendoj që, është marrë praktikë që shpeshhere të na sillen pikat e tillë, prandaj unë nuk jam që kjo pikë të hynë në rend të dites.

**z.Musli Neziri:** Meqense në e-mail na ka ardhë materiali, nese është ashtu në bazë me i zanë datat e planifikimit, mendoj që nuk është praktikë e mirë kjo që po bëhet, qoftë çfardo pike ose informate, por këto informata që po na vinë, këto letrat ne nuk mundemi me i skanu dhe ta shohim rezultatin e një procesi, prandaj mendoj që, nëse është në favor të komunës, ne jemi për, ne nuk jemi për mi ndal proceset, jemi për mi shty me i ndihmu. Çka është në interes të qytetarëve për neve është pranueshme.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Unë një pjesë të pikave që i kanë edhe në plane komunale, në planin e miratuar nga kuvendi komunal. Nëse drejtorat nuk i binë me kohë për komitet, nuk jam tu i ja pranu. E kemi fillu si praktikë, nuk i bjen me kohë, nuk i protokollon me kohë, nuk i pranojmë. Kjo pikë na ka ardhë sot, që është e protokulume, që duhet kalohet, sikur ju që e keni njëjtë e kam edhe unë, që na ka ardhë si propozim prej qeverisjes dhe jemi konsultu me nënkyreatrin, vetëm pikat që janë urgjente, që janë në interes të përgjithshem, që duhet të kalohen, jemi në gjendje me i përkrah.

**z.Hasan Aliu, nënkyretar I komunës:** Unë tregova, kjo më ka ardhë edhe mua një orë përrpara, nuk jam idhëtar i ksaj, por megjithatë thashë që, nganjëherë e lyp momenti me flakë uniformen edhe të këshilltarit edhe të ngjyrimit politik, kur është çështja e interesit të qytetarëve të Komunës së Vitisë. Informata që ka ardhë nga QKMF ka qenë KPF-ja dhe e ka kërku në këtë formë, varsisht se si e lypni, aty ku është ndikimi jonë, binduni, besën e keni që, ka me bë edhe ka me ardhë informacioni se si e lypë këshilltari i kuvendit komunal.

**z.Musli Neziri:** Nese nuk me keqkuptove, thashë: letra që na erdhë për mua ke e arsyeshme shpjegimi që e dha drejtoresha.

**z.Hasan Aliu, nënkyretar I komunës:** Pikërishtë për këtë e kam ftuar, është aspekt profesional, të cilët mundet me qenë më i afërt për pyetjet që i bëhen. Sherbyest çka janë civil, publik profesional e kanë obligim me ju ofru shërbim apo teknikë kuvendit. E kemi bisedu edhe me kryesuesin, jo vetëm shëndetësia aty ku kërkohet, në cilën zyre bëj kërkësën unë, e sjelli edhe zyrtarin në fjalë edhe informacionin e merrni të plotë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Te pjesa e informatave çka kërkohet, ajo vjen një informatë, mundet me sjell me shkrim, ndërsa pjesa e pikave vjenë me material me kohë, që shqyrtohet. Këto pikat urgjente mundet edhe të hynë këtu. Me ngritje të dorës: a jeni që kjo pikë të hynë në rend të ditës dhe të miratohet rendi i dites komplekt, se me shumicë të votave hynë edhe kjo? Me votat shumicë miratohet rendi i dites.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

## 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e rregullt e KK-së

**z.Jakup Demiri:** Po e sqarojë, pse votën e dhashë kundër. Fillimi i dokumentat e tillë, zakonishtë kjo për planin komunal të veprimit për energji dhe klimë nuk është ndonjë gjë që bjen në kundërshtim, por kjo nuk është urgjente, është urgjente ndoshta sa i përket formës së veprimit tarisë specifike, por nuk është urgjente për komunën veprimi për shpenzim të energjisë. E dyta, këto dokumente kur vinë, zakonishtë janë dokumenta të dostave, se ne e dimë se si funksionon komuna jonë, është komunë e dostave. Ne e dimë kush e merr atë e atë, por praktika mua nuk më pëlqen. Vjen dokumenti, votoje pa e lexu. Ku po jetë ai dinjiteti jonë.

**z.Musli Neziri:** Te procesverbali, te fjalimi im, aty faqe 18, një fajli është qapojmë në procesverbal, rreshti 4 ose i 5, faqe 18, duhet të jetë qalojmë, jo qapojmë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Me ngritje të dorës: kush është që të miratohet procesverbal? Atëherë, nga të gjithë miratohet procesverbal me ato plotësimin e tyre.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

## 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores me Nr.01-110/05-1057, të datës 29.09.2022 për taksa, ngarkesa dhe gjoba

**z.Besnik Imeri:** Përvendetje për të gjithë! Para jush po i paraqes vetëm ndryshimet për Propozim Rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba me Nr.01-110/05-1057. Ndryshimi i parë është të rregullohet nen 11, pika 11.3, të ndryshohet dhe plotësohet si në vijimë: dru teknikë për metër kubë në shumë prej 3 euro, ka qenë 2.5 euro; Drejtoria e Bujqësisë, vërejtje nga Ministria e Bujqësisë, nen 12, paragrafi 12.1.8, të ndryshohet dhe plotësohet si në vijim dhe duhet të jetë çiradhënia e banesave jepet duke u bazuarë në Ligjin 03L 164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit. Komuna gjatë dhënies me qera të këtyre banesave duhet t'i

kete prioritet personat qe kane me se shumti nevoje per banime, ndersa objektet qe jane ne pronesi te komunes jepen përmes ankandit publik edhe legislacionit në fuqi. Përmisimi tjetër, neni 28, paragrafi 28.1 i rregullores bazë, pas fjalës administrative i shtohet fjala kategoria e dytë, këtu ka të bëjë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, për çmimin e ndërtimit për metër katrorë duhet të ndahet nëpër zona. Vërejtja tjetër është neni 23, pjesa e 4 ndryshohet dhe plotësohet si në vijim, dhe duhet të jetë mospërfillja e pagesës së taksave së paku pasë 2 vërejteve do të rezultojë me iniciimin e procedurës së kundërvajtjes pranë Gjykatës Themelore - Dega në Viti, në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Kundërvajtje 05L087. Përmisimi tjetër ka të bëjë nga Ministria e Drejtësisë, neni 41 i shtohet pika 41.5. Me këtë përbajtje procedurat për sanksionim të kundërvajtësve me gjobë, duke përfshirë netet bazë të rregullores nga neni 38, 39, 40 dhe 41, ndëshkimet kundërvajtëse bëhen nga Drejtoria për Inspeksion. Detajet dhe arsyshmerin i keni mbrapa në fletën në vazhdim. Faleminderit!

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit Drejtor! Ju e dini që kjo miratohet me çështjen e buxhetit, kur të miratohet buxheti, nuk kanë pasë harmonizim këto pika në bazë të ligjeve dhe ministria aty ku nuk harmonizohen ata tarifa që janë i kthenë dhe është kërkua ky harmonizim i këtyre pikave.

**z.Musli Neziri:** Falemindert kryesues! Dhe drejtor këtu te përshkrimi që kanë dhanë ministria, shifet që e ka dhanë shablon se, në fund Komuna e Prizirenit. Po më duket që i kanë gra manual për të gjithë njëjtë. Por unë kisha dashtë të ngriti këtu, meqenëse i kanë rikthy ato ndryshime, kisha pas si kërkesë te neni 12, pika 12.1.4, ku fletë për shfryzimin e hapësirave pranë ndërtesave për aktivitet biznesi për rahatin e klientëve, kafiteri, siç janë restaurantet, duke u bazu në atë që është kërkua metri katror të shfryzohet 2 euro në zona. Ne e dimë që qyteti i Vitisë është i ndarë në 3 zona dhe fshatrat në zonën e 4. Pastaj edhe fshatrat janë të ndarë në 4 zona, tu nisë prej kësaj, tu e pasë parasysh që 2020 ka qenë pandamia, 2021, 2022 na përcjelli kjo pjesë kriza globale në 2022. Kjo ngarkesa 2 euro në muaj për metër katror shfryzimi i hapsirave publike para kafiterive, mendoj që 2 euro në muaj në qendër të qytetit nuk është shumë, por 1.70 në zonat, rrugët dytësore, mendoj që është shumë e madhe. Nëse hymë te fshatrat të cilat janë kategorizu në zonën 1, siç është prej Budrikës deri në Ramjan, zona magjistrale, nuk mendoj që ta ketë barrën e njëjtë të ngarkesës së gjobës sikur një restaurant ose kafiteri, në restaurant në Pozheran sikur në qendër të Vitisë, përshkak të frekuentimit të njerëzve normalisht. Meqenëse janë kthyer këto që të janë në harmonizim, kisha pas si kërkesë që, këto të ulen në zonat tjera e sidomos në zonat e fshatrave që janë kategorizmi prej Budrikës deri në Ramjan si zonë 1. Mendoj që kjo të ulet të jetë 1 euro për metër katror ose 0.50 cent.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit Musli! Por vetëm këto qka na e kanë kthy kemi mundësi me i ndryshu, se është plotësim ndryshim, ajo pjesë është pranu prej ministrisë, ata i kan dergu netet që duhet ndryshim, jashtë atyre pikave nuk mundemi.

**z.Ali Bajrami:** Propozim rregulloren për taksa ngarkesa dhe gjoba që ka ardhë me vërejtjet e MAPL-së dhe duhet të harmonizohet në bazë të ligjit, se vërejtjet që na i kanë dergu, kanë qenë ndesh, prandaj me këtë propozim ndryshim ne do ta mbështesim dhe do të votojmë pro ksaj rregullore. Faleminderit!

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kush është me ngritje të dorës të votohet kjo pikë e rendit të ditës? Me të gjitha votat prezantë miratohet kjo pikë e rendit të dites.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

### **3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2022-2026**

**z.Nexhat Arapi, kryeatr i komisionit për hartimin e strategjisë:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2022-2026 është në kuadër të planeve strategjike që nxjerr komuna, që dalin si obligim për institucionet e Kosoves, në këtë rastë komunën tonë, që të kemi standarde europiane të funksionimit institucional. Kjo strategji është hartuar nën rekomandim të Ministrissë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe në përputhje me Udhëzuesin për hartimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal. Procesi i hartimit të strategjisë lokale ka filluar me propozimin e kryetarit të komunës, i cili në miratim të posaqem ka themeluar komisionin për hartimin e strategjisë, i cili komision kordinon procesin e hartimit të këtij dokumenti. Procesi hartimit dhe implemetimit të strategjisë është i bazuar në principin e qasjes participuese, që do të thotë përfshirjen e të gjithë akterëve, mekanizmave dhe palëve të interesit gjatë tërë procesit. Në këtë kontest, që në fillim grupi koordinues ka zhvilluar takime me përfaqësuesit e drejtorive dhe sektorëve të qeverisjes komunale, duke

grumbulluar te dhenat dhe shenimet rreth gjendjes dhe rrjedhave te pergjithshme pas analizimit klasifikimit dhe sistemimit të të dhënavë. Është prezantuar gjendja aktuale që përfshihet në kapitullin e parë, ndërsa në kapitullin e dytë janë pasqyruar sfidat e zhvillimit lokal në sektorët e caktuar si dhe janë paraqitur rezultatet e sfot analizës si mekanizëm esencial për identifikimin dhe evidentimin e përparësive dhe mundësive si faktor bazikë për planifikim të mirë zhvillimor dhe janë lokalizuar dobësitetë dhe rreziqet si elemente që do të eleminohen, kurse në kapitullin 3 janë prezentuar objektivat zhvillimore, ku jemi përcaktuar në 3 objektiva: zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, zhvillim i qëndrueshëm social dhe menaxhimi i qëndrueshëm. Në këtë kapitull gjithashtu është prezentuar edhe plani aksional, duke përfshirë kostutimën e aktiviteteve, bartësit e aktivitetve dhe afatet kohore për realizimin e tyre. Dhe në fund të këtij kapitulli është përshtuar sistemi i administrimit dhe monitorimit të implementimit të kësaj strategjie përmes evoluimit të vazhdueshëm. Strategjia për zhvillim ekonomik lokal në të vërtet paraqet planin e përgjithshem strategjikë të zhvillimit të komunës, i cili ka për qëllim aktivizimin e të gjitha kapacitetave dhe potencialet e disponueshme në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm socioekonomik lokal. Ky dokument strategjik pretendon Vitinë ta shndërroj në një lokalitet me zhvillim të barazpeshuar, që do të mundësoj integrim ekonomikë social përmes avansimit të partneritetit me sektorin publik, privat, civil me ambient të volitshëm dhe atraktiv që lehtëson dhe favorizon aktivitetet ekonomike dhe nxitë investitorët potencial të ju ofron qasje dhe mundësi të barabarta me zona turistike të zhvilluara, të bazuara në resurset natyrore dhe trashëgimin kulturore, me infrastruktur moderne me hapësirë të menaxhuar në bazë të planifikimit urban dhe mjedis të përshtatshem ekologjikë, që krijon një ambientë të shendoshë dhe atraktivë për jetesë, me një administratë efikase dhe efektive në shërbim të qytetarëve dhe ekonomisë së saj dhe me kapacitete të avansuara për bashkëpunim dhe koordinim ndërinstitucional. Ky dokument strategjik mbështet në dokumente ligjore si dhe nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Planin strategjik afatmesëm dhe afatgjatë të qeverisjes së Kosoves, Ligji mbi Vetëqeverisje Lokale, Ligji mbi Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësive, Statutin e Komunës, Kornizën afatmesme buxhetore, draftplani zhvillimor 2022-2030 dhe ligjeve pozitive në fuqi, duke filluar prej Ligjit për Investime Strategjike deri te Ligji për Partneritet Publiko Privat. Po ashtu ju kemi referu edhe strategjive të mesme dhe alternative si pasuese të zhvillimit strategjik komunal, Plani zhvillimore 2010-2020, Planin e integruar komunal 2018-2021, agjenton zhvillimore 2004-2007 dhe strategjinë 2003-2006. Procesi hartimit është konform udhëzuesit për hartimin e strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal edhe në përputhje të plotë me manualin për hartimin e strategjisë, duke respektuar në tërësi listat e hapave për hartimin dhe përfundimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal. Kjo strategji është hartuar në bashkëpunim të plotë dhe të gjithanshëm në strukturat udhëheqëse të Komunës së Vitisë dhe në koordinim të vazhdueshëm me kryetarin e komunës dhe kryesuesin e kuvendit. Implementimi i strategjisë është veprimi më i rëndësishëm për suksesin e saj. Për implementimin e saj është i nevojshëm participimi i strukturës administrative dhe të gjithë akteret relevant dhe hapi i parë në këtë drejtim është miratimi i këtij dokumenti, duke patur parasysh rëndësinë e këtij dokumenti, i cili do të jetë udhëzues dhe instrument orientues i punës së organeve komunale në të ardhmen, dhe fakti se pas miratimit ky dokument do të kaloj në pronësi të komunës, ju ftoj pas shqyrtimit ta mirtoni këtë strategji. Faleminderit!

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit, z.Nexhat Arapi! Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Musli Neziri:** Përhendetje për ju, z.Nexhat! Të faleminderoj për mundin dhe angazhimin që e keni bërë gjithë ajo ekipë. Unë dashta me u nderlidhë tek ato në arsim që janë cekë. I lexova me kujdes pikat, kenë mirë të përpilume, por nëse është e mundur i kisha shtu edhe diçka kësaj. Te strategjita nuk pash krijimin e një grupei të ekspertëve të arsimit në nivel komunal, ku detyrat e këtij grupei do të janë që të përgatisin një planë veprimi që do të merren konkretisht me fushën e arsimit dhe ky grupei i ekspertëve ne të ketë drejtore, profesorë, mësues dhe gjithë bashkarisht që ta dimë një strategji se ka po e orjetojnë mësimin në qytetin e Vitisë, për çka me i gjenë saktë kërkosat e nevojat në arsim, se ku jemi. Si pjesë tjetër kemi parë që mungonë një krijim i një ekipi të kordinatoreve në fushës, e si ekspert i kurrikules që janë, që ta bëjnë një unifikim të planeve të arsimit. Përsembull, jo ai mësimdhënës i Matematikës në një fshatë të punoj me një libër siç është libri shkollor ose libri dukagjini, ose cila do që të jetë ndoshta një mësim dhënës tjetër punon diqka tjetër, dhe kur dalin nesër në gara që mbahen mes shkollave, që një pjesë nuk i dinë një pjesë, një i dinë. Prandaj, kisha kërkoi që grupei i kordinatoreve të fushës së kurrikules, që të ulen të punojnë për një tekst shkollor, sepse ajo do të jetë unifikim i sektorit të arsimit. Pjesë tjetër që është cek, trajnimi i stafit të mësimdhënësve i vazhdueshëm, që unë e përkrahi këtë pjesë, por kisha kërkoi që të jetë strategji edhe zbatueshmeria e atyre trajnimve, që të mund të përcjellen apo

mbahen apo jo. Ijetra, së strategjipse mos te parashihet qe te mbahet një gare e dijes ne nivel shkollor, po qotte edhe në nivel republikan, në kuadër të Komunës së Vitisë, që Vitia të jetë model se si do të mund të organizohet një garë ndoshta edhe shtetrore me të gjitha nivelet e shkollimit. Te strategjia nuk e pashë që është përkrahja e nxësnësve talent. Të ketë një strategji se si të nxjerren nxënësit inovativ, nuk e pashë atë pjesën përkrahja e nxënësve të shkollave profesionale, një diçka që na ka rastis, që komuna e Kaçanikut ka marrë një veprim, në projektë buxhet e ka parapa që të përkrahet udhëtimi i nxënësve, të paguhet nga komuna. Në vitin tjetër kur të bëjmë planifikim për buxhetin, ndoshta 2023-2024 do të tentojë me shty këtë proces gjithqysh, që të jenë të përfshirë në shkolla profesionale.

**znj.Liridona Bislimi:** Faleminderit kryesues, faleminderit edhe një here prej komisionit për elaburimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal! Unë kam pas një diskutim begi të bukur edhe te KPF, gjithashtu kam qenë pjesmarrëse edhe në diskutimin që është mbajt me datën 2 Nëntor, edhe aty e kam bërë vërejtjen e njëjtë, ku duhet me përserit prapë, që prej 17 anëtarëve të komisionit, vetëm 2 prej tyre përfaqësuesve janë gra. Pra, për neve është e papranueshme, nëse mendon që në të gjithë Komunën e Vitisë nuk ka më shumë gra të cilat kanë pasur mundësi të janë më shumë kontributdhënëse në këtë ekipë punuese. Ndërsa tjetra, gjatë diskutimit publik ku është mbajtur, ku kam qenë edhe unë prezent, kemi pasur një numër të konsiderueshëm përfaqësues të bizneseve në Komunën e Vitisë dhe ata kanë shprehur një shqetësim, që në diskutimet ku marrin pjes ankesat e kërkesat e tyre nuk është që po trajtohen me seriozitet, me një formë nuk është që po merren parasysh. Edhe përgjigjja që ka qenë nga ana e përfaqësuesve të ekzekutivit, ka qenë se ende jemi në përfundim të draftit të strategjisë, dhe në fund gjithsecili atë diskutim që e kanë mbajtur ka me u trajtu me seriozitet. Prandaj mua po më intereson me ditë, gjatë diskutimit atë ditë kam pasur vërejtje, sfida, mangësi prej përfaqësuesve të bizneseve që i kanë parashtru. Po më intereson me ditë, cila prej tyre janë marrë janë trajtu dhe janë vendosurë në këtë strategji të zhvillimit ekonomikë lokal. Faleminderit!

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Unë kam qenë edhe bizneset kur e kanë dhanë vërejtjen se sa po përfille, por ata nuk e kanë thanë një element që kjo nuk është përfill. Edhe te kjo pjesa e Musës, besoj që drafti kalon me vërejtje dhe një pjesë të shqyrtohet, cilat janë mundësítë me hi, nuk do të thotë se çka propozohet me hi, mirëpo si ekip e kanë obiligmë në momentin që votohet vërejtjet mi marrë me i plotësu.

**z.Përparim Sadiku:** Përhendetje për të gjithë! Fillimi sht, strategjia është hartu prej një grupei punues që janë zyrtarët e Komunës së Vitisë, por në bashkëpunim edhe me faktorë të jashtëm të interesit dhe njohurive që kanë rrëth hartimit të strategjisë, po dhe me drejtoret komunale, në bashkëpunim të ngushtë edhe me kryetarin e komunës. Ne jemi mundu ta paraqesim një fotografi të plotë që ta shndërrojmë Komunën e Vitisë si mundësi për zhvillim ekonomik dhe në atë fotografi janë përbledhë shumë mundësi që i ka Komuna e Vitisë për me u shndërru në një komunë që është atraktive për zhvillim ekonomik. Edhe te asambleisti që i paraqiti disa kërkesa për me inkorporu brenda kësaj strategjie, që janë të rëndësishme, por diçka brenda strategjisë ka. Përshembull ne i kemi parapa aty, që të shihet mundësia e zgjerimit nëpër shkolla të mesme profesionale, mirëpo kjo bëhet në raport me një bashkëpunim me bizneset që kanë nevojë për ato drejtime profesionale dhe ekspertë të lamisë arsimore. Gjithashtu është edhe kjo që e përmendi krijimi i grupit të eksperteve për hartimin e planit zhvillimor. Shikoni, kjo është një strategji që është diçka më e përgjithshme, prej kësaj strategjie mund të merren planet më konkrete, se ne nuk kemi mundur t'i paraqesim të gjitha. Strategjia është diçka që rrinë si kupolë planifikimit më operativ, por që janë të rëndësishme si kërkesa dhe do ti shohim dhe t'i kemi parasysh nëse është mundësia me i fut këtu ose lihen për ata që mirren mandej me planin e zhvillimit arsimor. Tek çështja e koordinimit të cilësisë, mundësi për me i bashkorganizu. Kjo duhet shihet edhe në kuadër të ligjit, sa është mundësia me i anashkalu disa tekste të cilat Ministria e Arsimit i ka udhëzu, dhe në një formë ju ka dhanë leje për me i përdor. Kjo është çështje që mendoj që lihet nën vullnetin e mësimdhënësit se, me cilat tekste donë të punojë, por është një mundësi dhe duhet të shikohet mundësia edhe nga njerëz që vinë nga lamia e arsimit, se sa është mundësia mu inkorporu një formë e bashkëpunimit mes kordinatoreve dhe të zgjidhen tekstet të cilat janë më të kapshme edhe për nxënësit, sepse qëllimi është që nxënësit të përfitojnë prej tyre. Sa i përket pyetjes së Liridores, ne jemi mundu me formu një komision, por ai komision është formu nga Zyra e Kryetarit në bashkëpunim me kryesuesin, e që kemi aty edhe femra. Mendoj që edhe kryesuesi mund të jap ndonjë përgjigje. Sa i përket bashkëpunimit me biznese, ne i kemi mbajt dy aktivitete, i kemi marrë kërkesat e tyre, jemi mundu me i inkorporu brenda strategjisë dhe ka kërkesa të bizeseve që janë brenda strategjisë, dhe siç thashë në fillim, strategjia është diçka që është e

pergjithshme dhe nuk jemi ule ne çeshtje konkrete, sepse çeshtjet konkrete i mbeten mandej planifikimeve qe vijnë vitë pas viti, edhe prej drejtoreve, edhe prej ekspereteve në fushat e caktuara. Faleminderit!

**z.Musli Neziri:** Faleminderit Përparim për sqarimet! Mendoj që, të gjitha ato që u thanë nga unë nuk do të thotë që duhet të përfshihen patjetër, unë thash, ajo çka është e mundshme me u bë është mirë mu marr bashkarisht me e këshyrë edhe njëhere. Unë e di që ministria i ka leju, po na kemi fusha të veçanta, si p.sh.: bëhet trajner i kurikules dhe kur po dalin napër rezultate krejt diqka tjetër, prandaj kërkoi mu bë një unifikim i tyre, me u ulë me i formu ato, me ju dhanë detyra të caktuara e me i kry. Ne e dimë që napër secilën shkollë kemi edhe koordinator të cilesisë, po sa është funksionale, nëse është ai atëhere duhet me e funksionalizu ato. Besoj që të gjitha ato që i thash kontribojnë në pjesën e arsimit.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka të tjer per diskutim, qes në votim per miratim këtë pikë të rendit të ditës. Me të gjitha votat prezant votohet kjo pikë, kundër nuk, ka apstenim nuk ka.

Si pike të katër të rendit të dites kemi:

#### **4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për krijimin e kodeve të ri për projektet me participim**

**z.Naim Pira drejtor:** Përshendetje të nderuar të pranishem! Para juve kemi sjell Propozim vendimin për krijimin e kodeve të rindërimit. Edhe në seancat e kalume e kemi pas një praktikë të tillë. Propozim vendimin që e keni para duhet të permisohet, sepse i kemi dy gabime. Kërrkoj nga ju që të hasni në mirkuptim, fjala eshte tek shuma, tek furznizimi me gërbula, ku kemi vlerën 2 mijë e 850, dhe 20% të participimit. Nuk duhet të jet 5 mijë e 770 euro, po duhet të jet 4 mijë 170 euro. Dhe tek furnizimi me koshere të bleteve, në vend të 25%, duhet të jete 20%, dhe e kemi përmirësu gabimin, kemi 2970 euro. Me mirkuptimin e juaj e kemi edhe një projekt furnizim me sperkatese, i cili nga muaji i shtatë ka qenë në OSHP dhe per munges të funksionalitetit të tyre, sepse unë kam qenë dy here aty, e kanë vonu pa arsy me shumë se 3 muaj, e dje e kemi marr konfirmimin që e ka marr epilogun final. Unë kërkoi nga ju që, ta fusim edhe kodin përfshirë me spërkatëse, ku është vlera 28 mijë e 380 dhe në llogaritje 20% i bjen 5 mijë e 676 euro që do të participojnë 60 bujqë, që do të përfitojnë këtë projek.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pik të rendit të ditës. Pasi që nuk ka përfshirë diskutim, qes në votim për miratim. Me votat e të gjithëve miratohet edhe kjo pikë e rendit të dites.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

#### **5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në konsultim publik të draft Rregulllore për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.**

**z.Hasan Aliu, nënkytar i komunës:** Matrialin e keni marr me kohë. Këtë rregullore e ka përgadit niveli qendror në koordinim me zyrat ligjore të cilët e kanë kolegjumin e Zyrës Ligjore dhe janë dakordu që, të gjitha komunat ta kenë një rregullore të tillë. Kërkojmë nga ju të miratohet kjo rregullore që të del në konsultim publik.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka, e qesë në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmi u miratu edhe kjo pikë e rendit të dites.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

#### **6. Propozim për miratimin e planit komunal të veprimit për energjinë dhe klimën për vitet 2022-2030**

**z.Xhelal Musa, inxhinier:** Përshendetje të nderuar të pranishëm! Hartimi i planit në fjalë është obligim ligjor sipas Ligjit për Eficiencë të Energjisë 06L-079 dhe kërkosave ndërkombëtare si traktat të komiteteve të energjisë, ku Kosova është pal kontraktuese. Pastaj konventa e kryetarve të komunave të nënshkrua në vitin 2015. Materialin e keni para vete, për pyetjet shtesë jame në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Jakup Demiri:** Pershendetje edhe njëherë! Ne e votuam, unë isha kundër si pikë e rendit të ditës me hi për shkak si procedurë, po si vërejtje e kisha dhamë në këtë rast edhe tek Xhelali po edhe tek ju, se më mirë ish kanë një sqarim në fillim e jo vetëm me naj pru një dokument kështu, sepse ne nuk jemi kundër investimeve, po praktika si po na vjen me vonesë, edhe shumica që vin kështu me nguti po kthehet prej ministrisë prapë. Ne po e votojmë

kete dokomt, sepse po e ndegjojme se eshte ne interes tonin, te qytetareve tane, mirepo ne kem kunder procedures se si erdhi kjo pikë me vones.

**Kryesuesi, z. Bekim Azizi:** As ne në grupin tonë nuk e kemi diskutu, sepse edhe neve na ka ardh kështu. Pasi që nuk ka për diskutim: a jeni me ngritje të dorës që të votohet kjo pikë e rendit të ditës? Me të gjitha votat prezent u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:30 min.

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Bekim Azizi**

---



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

## STATUTI

Për

Ndryshim plotësimi i Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të  
datës 21.04.2011

Maj 2022

Në mbështetje të Vendimit Nr. 01-110/05-219, të datës 01.03.2022 për miratimin e iniciativës së kryetarit të Komunës së Vitisë për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës së Vitisë, në mbështetje të Vendimit Nr.01-110/05-218, të datës 01.03.2022 për emërtimin e komisioni për përgatitjen e ndryshim plotësimit të Statutit të Komunës së Vitisë me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, Komisioni rekomandon këto ndryshim plotësime.

## S T A T U T I

### **Për ndryshim plotësimi i Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011**

#### **Neni 1**

Neni 13, paragrafi 13.3 të statutit bazë, riformulohet si ne vijim: kandidatët për pozita të anëtarëve të këshillit lokal apo kryetarëve të këshillave lokal nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur/emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve/partive politike.

#### **Neni 2**

Neni 28, paragrafi 28.2 të statutit bazë, riformulohet si në vijim: mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga kryetari (aty ku është zgjedhur) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e çertifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

Neni 28, paragrafi 28.3 të statutit bazë riformulohet si në vijim:

Nëse kryetari i Komunës nuk e thirret mbledhjen sipas paragrafin 28.2 të këtij nenit, mbledhja inauguruese thirret nga anëtarë më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit të Komunës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur kryetari është dashur ta thërras mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës.

#### **Neni 3**

Neni 30, paragrafi 30.3 të statutit bazë i shtohet shkronjat d, seancë urgjente dhe seanca inauguruese.

#### **Neni 4**

Neni 32 i statutit bazë, shtohet nenit i ri 32 A me tekstin si në vijim: 1. Mbledhja urgjente thirret ne raste të fatkeqësive natyrore apo rrëthanave tjera urgjente në komunë dhe 2. Procedurat e thirrje se mbledhjeve urgjente nuk zbatohen si në rastin e thirrjeve te mbledhjeve tjera.

#### **Neni 5**

Neni 47, paragrafi 47.2, shkronja e) të statutit bazë: Tek shkronja e) Komitetit për Mundësi të Barabarta dhe Barazi Gjinore, riformulohet dhe ka këtë përbajtje: e) Komiteti për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore. Dhe tek shkronja h) Komiteti për Zhvillim Rural, riformulohet dhe ka këtë përbajtje h) Komiteti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

#### **Neni 6**

Neni 56, paragrafi 56.1 të statutit bazën, nënparagrafi 2, riformulohet si ne vijim:

- 2.a. Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- b. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

#### **Neni 7**

Neni 62, paragrafi 62.I të statutit bazë, togjalëshi: "Drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim"; riformulohet: Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

#### **Neni 8**

Neni 64, paragrafi 64.I të statutit bazë, togjalëshi: "Drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim" riformulohet: drejtori Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

#### **Neni 9**

Neni 65, paragrafi 65.I të statutit bazë: togjalëshi i Ligjit për Shërbimin Civil Nr. 03/L-149, i paraparë në të gjitha nenet e statutit bazë, ndryshohet dhe do të jetë Ligji për Zyrtarë Publik Nr. 06/L-114.

### **Neni 10**

Neni 68 paragrafi 68.1 të statutit bazë: riformulohet si ne vijim: Me qëllim të planifikimit, administrimit, punësimit të zyrtarëve publik në përputhje me nenit 14 të Ligjit për Zyrtarë Publik Nr. 06/L-114, Komuna e Vitisë themelon Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

### **Neni 11**

Neni 69 paragrafi 69.1 dhe në nenet pasuese të statutit baze ku cekët: Njësia e personelit dhe Udhëheqësi i personelit, duhet te zëvendësohet me Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Udhëheqësin e Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

### **Neni 12**

Neni 69 paragrafi 69.3 të statutit bazë: riformulohet si ne vijim: Udhëheqësin i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore rekrutohet nga kandidatet e nëpunësve civil të nivelit udhëheqës me përvojë 5 vjeçare dhe kualifikim superior nga fusha përkatëse e drejtësisë.

### **Neni 13**

Neni 70 paragrafi 70.2 të statutit bazë: riformulohet si ne vijim: Në bashkëpunim dhe konsultim me kryetarin e Komunës dhe sipas planit vjetor dhe afatmesëm të personelit përgatit, menagjon dhe publikon konkurset, në përputhje nenin 15,16,17 të Ligji për Zyrtarë Publik Nr. 06/L-114.

### **Neni 14**

Neni 74, paragrafi 74.1 të statutit bazë: shkronjë a riformulohet si në vijim:  
a- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

### **Neni 15**

Neni 74, paragrafi 74.1 shkronja g të statutit bazë riformulohet si në vijim:

g) Zyra për Komunikim me Publikun.

### **Neni 16**

Neni 74, paragrafi 74.1 të statutit bazë: shtohet edhe një shkronjë L me emërtimin:

L - Sektori për Punë të Kuvendit Komunal të Vitisë.

### **Neni 17**

Neni 74, paragrafi 74.2 të statutit bazë: fshihet nga statuti bazë dhe paragrafi 74.3 i statutit bazë merr paragraplin 74.2.

### **Neni 18**

Me hyrjen në fuqi të këtij ndryshim plotësimi të statutit, të gjitha aktet nënligjore të komunës do të harmonizohen brenda gjatë (6) muajve.

### **Neni 19**

Pas miratimit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës së Vitisë, pushojnë të vlejnë dhe shfuqizohen dispozitat e ndryshuara dhe të plotësuara të statutit Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011.

### **Neni 20**

Ndryshimet dhe plotësimet në statut hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nemit 8 lidhur me nenit 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Fatih Demiri

Kryetar i komisionit për ndryshim- plotësim të statutit





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality Viti/na

**Statutit i Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011  
( nenet bazë të statutit e të cilët propozohen për ndryshim-plotësim)**

**Maj 2022**

## **Statutit i Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011 ( nenet bazë të statutit e të cilët propozohen për ndryshim-plotësim)**

### **Neni 1**

Neni 13 paragrafi 13.3 i statutit bazë: Gjatë themelimit ( zgjedhëjes) së këshillave të fshatrave dhe të këshillit të qytetit të Vitisë dhe emërimit të kryetarve të këtyre këshillave, duhet respektuar përfaqsimin proporcional të subjekteve politike, në përbërjen e këtyre këshillave dhe në kryesimin e tyre.

### **Neni 2**

Neni 28, paragrafi 28.2 të statutit bazë: Mbledhja e parë inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga kryesuesi i përbërjes paraprake të Kuvendit të Komunës në afatin si nga par.1. i këtij neni.

Neni 28, paragrafi 28.3 të statutit bazë Nëse Kryesuesi nuk e thirret mbledhjen sipas detyres zyrtare si në par.2.të këtij neni, mbledhja konstitutive mund të thirrët nga antari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit Komunal mbrenda afatit prej 15 ditësh, nga data kur kryesuesi nga par.2. i këtij neni është dashur të thërras mbledhjen inauguruese.

### **Neni 3**

Neni 30, paragrafi 30.3 të statutit bazë i shtohet shkronjat d, seancë urgjente dhe e, seanca inauguruese.

### **Neni 4**

Neni 32 i statutit bazë, shtohet neni i ri 32 A me tekstin si në vijim: 1. Mbledhja urgjente thirret ne raste të fatkeqësive natyrore apo rrëthanave tjera urgjente në komunë dhe 2. Procedurat e thirrje se mbledhjeve urgjente nuk zbatohen si në rastin e thirrjeve te mbledhjeve tjera.

### **Neni 5**

Neni 47, paragrafi 47.2 të statutit bazë shkronja e- Komitetin për mundësi të barabarta dhe barazi gjinore. h- Komitetin për zhvillimin e Rural.

### **Neni 6**

Neni 56, paragrafi 56.1 të statutit bazën nënparagrafi 2: Drejtoria për Financa, ekonomi dhe zhvillim;

### **Neni 7**

Neni 62, paragrafi 62.1 të statutit bazë, Të gjitha qështjet që lidhen me administrimin financier të Komunës së Vitis ,udhëhiqen dhe janë përgjegjësi e Kryetarit të komunës ,të cilat përgjegjësi kryetari mundë ti bartë me autorizim te nënkyetari I komunës dhe te drejtori I drejtorisë për financa ekonomi dhe zhvillim.

### **Neni 8**

Neni 64, paragrafi 64.1 të statuti bazë, Drejtori i drejtorisë për financa ,ekonomi dhe zhvillim duhet në qdo kohë ti afroj informacione kryetarit të komunës për gjendjen financiare buxhetore ,për të gjitha kategorit dhe njësit buxhetore të Komunës .

### **Neni 9**

Neni 65, paragrafi 65.1 të statutit bazë: Shërbimi civil Komunal në Komunën e Vitisë përfshin të gjithë personat e punësuar nga autoriteti Komunal ,pagat e të cilëve paguhën nga buxheti I Republikës së Kosovës ,dhe sipas Ligjit në fuqi për Shërbimin civil të Republikës së Kosovës ( Nr 03/L-149) kanë statusin e nëpunësve civil dhe janë pjesë e shërbimit civil të Kosovës .

### **Neni 10**

Neni 68, paragrafi 68.1 të statuti bazë: Me qëllim të planifikimit ,administrimit dhe mbikqyrjes së strukturave të shërbimit civil Komunal të administrates komunale dhe përmbytjes së detyrimeve dhe kërkesave nga neni 7.të LSHC. Të Republikës së Kosovës lidhur me nenin 10.par.2.shkronja f të këtij statuti – konstituohet-Njësia për menagimin dhe zhvillimin e personelit dhe të burimeve njerzore të shërbimit civil komunal –NJËSIA E PERSONELIT.

### **Neni 11**

Neni 69, paragrafi 69.1 të statuti bazë: Njësia e personelit e shërbimit civil komunal, ka udhëheqësin e personelit.

### **Neni 12**

Neni 69, paragrafi 69.3 të statuti bazë: Udhëheqësi i personelit regrutohet nga kandidatët shërbyes civil të karierës me përvjetorë mbi 3 vjeqare dhe kualifikim profesional superior në fushat përkatëse të drejtësisë dhe me konkurs publik.

### **Neni 13**

Neni 70, paragrafi 70.2 të statuti bazë: Në bashkpunim dhe konsultim permanent me kryetarin e Komunës dhe sipas kërkesave të arsyetuar të drejtorve të drejtorive të administrates komunale harton dhe publikon konkurset për plotsimin e vendeve të lira të punës për shërbyesit civil.

### **Neni 14**

Neni 74, paragrafi 74.1 të statuti bazë: a-Njësia e personelit të shërbimit civil Komunal.

### **Neni 15**


Neni 74, paragrafi 74.1 të statuti bazë shkronja g-Zyra për marëdhëniet me publikun

Neni 74 paragrafi 74.1 të statutit bazë: shtohet edhe një shkronjë L me emërtimin  
L - Sektori për Punë të Kuvendit Komunal të Vitisë.

### **Neni 16**

Neni 74, paragrafi 74.2 të statuti bazë Kryetari i Komunës në mbështetje të nenit 50 par.1 shkronja s të këtij statuti, themelon sektorin për demokratizim në kuadrin e përgjegjësive të të cilit do të jenë koordinimi, menagjimi dhe përgjegjësitë për zyrat dhe njësit nga par.1.shkronja c,g,h i dhe k, të këtij neni.

Fatihem



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VITISE / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA



Në bazë të nenit 11, 14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit mbi vetqeverisjn lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrare nr.28/2008 dhe neni 13 dhe 8 paragrafi 3, të Ligjit me nr. 06/L-092 , Për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe neni 50 paragrai 1 shkronja l, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës me datën 07.12.2022, bën këtë :

**PROPOZIM VENDIM**  
**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË VEQANT TË PRONAVE TË PALUJTSHME TË KOMUNËS QË**  
**PLANIFIKOHEN PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM GJATË VITIT 2023**

Neni 1

Me këtë propozim – vendim , propozohet të miratohet Lista e veqant e pronave të palujtshme të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shftytëzim gjatë vitit 2023.

Neni 2.

Lista sipas nenit 1 të këtij propozim-vendimi për secilen pronë arsyetimin e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik të Komunës , të dhënat kadastrale , qellimin e dhënjes në shfrytëzim , destinimi i pronës parashikimi.

Neni 3

Pjesë përberse e këtij propozim vendimi është Lista e veqant e pronave të të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023 përfshirë cartifikaten e pronës dhe kopjen e planit.

Neni 4

Për zbatimin e këtij propozim – vendimi dhe procedurat tjera të parapara ,me të Ligjit me nr. 06/L-092 , Për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës Obligohet Drejtoria e Kadastrit, Pronës dhe Gjeodezisë ne bashkpunim dhe kordinim me Drejtorit tjera të Komunës varsisht fushveprimtarisë përkatëse. Zyra e Kryetarit të Komunës , Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Financave të komunës së Vitisë.

Neni 5.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.





Policia - Fusha e Policia	Nr. i Organit - Numri i brojt	Shtetëse - Puna	Vlera - Vlera
---------------------------	-------------------------------	-----------------	---------------



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA**

**LISTA E VEQANT E PRONAVE TË PALUJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHET PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM GJAT VITIT 2023.**

Nr	Të dhënrat kadastrale të pronës	Arsyetimi i interest publik dhe zhvillimi ekonomik	Destinimi	Periudha kohore për dhënjen në shfrytëzim të pronës së palujtshme
1.	Njësisë kadastrale P-70101023-00991-0 në sipërsaqe prej 33358 m <sup>2</sup> , Njësisë kadastrale P-70101023-01576-0 në sipërsaqe prej 10553 m <sup>2</sup> , Njësisë kadastrale P-70101023-01577-0 në sipërsaqe prej 142999 m <sup>2</sup> në zonën kadastrale në Zhiti	Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë.	Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për shfrytëzin bujqësor	Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter.
2.	Njësisë kadastrale P-70101012-00641-7 në sipërsaqe prej 110044 m <sup>2</sup> , në zonën kadastrale në Budrikë e Epërme	Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë.	Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për shfrytëzin bujqësor	Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter.
3.	Palujtshmeria e evidentuar në, numri i njësisë kadastrale: P-70101012-00641-1 në sipërsaqe prej 155000 m <sup>2</sup> , Bujqësore, në vendin e quajtur "Batanica" në zonën kadastrale në Budrikë e Epërme.	Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës.	Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për Zonë industrial – ekonomike.	Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatgjat.
4.	Njësit kadastrale me numër : P-70101007-02592-3, në sip. prej 102m <sup>2</sup> P-70101007-02592-4, në sip. prej 53m <sup>2</sup> P-70101007-02592-5, në sip. prej 96m <sup>2</sup> P-70101007-02592-6, në sip. prej 104m <sup>2</sup> P-70101007-02592-7, në sip. prej 156m <sup>2</sup> P-70101007-02592-8, në sip. prej 118m <sup>2</sup> Në zonën kadastrale në Viti.	Pronat e cekura planifikohen të jepen në shfrytëzim për parkingje publike, krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë	Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për parkingjet publike	Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter
5.	Njësisë kadastrale me numër: P-70101018-00175-0, në sip. 211198 m <sup>2</sup> , P-70101018-00197-0, në sip. 96342 m <sup>2</sup> , P-70101018-00200-0, në sip. 130577 m <sup>2</sup> , P-70101018-00211-2, në sip. 8142 m <sup>2</sup> , P-70101018-00211-4, në sip. 206276 m <sup>2</sup> , Në zonën kadastrale në Devajë.	Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë.	Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për shfrytëzin bujqësor	Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter.

6.	Njësisë kadastrale me numër: P-70101016-00528-0, në sip. 2804 m <sup>2</sup> , P-70101016-00527-0, në sip. 6416 m <sup>2</sup> , P-70101016-00498-0, në sip. 10392 m <sup>2</sup> , P-70101016-00499-0, në sip. 4785 m <sup>2</sup> , P-70101016-00500-0, në sip. 13896 m <sup>2</sup> , P-70101016-00529-0, në sip. 27085 m <sup>2</sup> , P-70101016-00503-0, në sip. 16364 m <sup>2</sup> , P-70101016-00502-0, në sip. 11070 m <sup>2</sup> , P-70101016-00501-0, në sip. 8205 m <sup>2</sup> , Në zonën kadastrale në Gushicë.	Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë.	Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për shfrytëzimin bujqësor	Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter
7.	Njësisë kadastrale P-70101040-01784-1 në sipërsaqe prej 37151 m <sup>2</sup> , Toka pyjore në vendin e quajtur "Zhar zhar" P- 70101040-01785-0 në sipërsaqe prej 3968 m <sup>2</sup> , në zonën kadastrale në Sadovinë e Çerkezëve	Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë.	Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim per shfrytëzimin bujqësor	Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter.

Me datën 07.12.2022, Viti.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pronar - Përfundim i takimit	19-12-2022		
Nr.i organit	Nr. i takimit	Shtetet	Vlera
Org. broj		Princip	Vredheta
02-035 / 02-1486			



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

**PROPOZIM RREGULLORE  
PËR PLOTËSIMIN E RREGULLORES  
PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA, ME NR. 01-110/05-1057, E DATËS. 29.09.2022**

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1, pika h të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenit 2 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me nenin 9 dhe 13 të ligjit nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, kërkesën me Nr. 43-870/8, e datës 15.12.2022 nga MAPL-ja si dhe nenit 50 paragrafi 1 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

**PROPOZIM RREGULLORE  
PËR PLOTËSIMIN E RREGULLORES  
PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA ME NR. 01-110/05-1057, E DATËS 29.09.2022**

**Neni 1**

Kjo rregullore ka për qellim plotësimin e rregullores bazë për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale me Nr. 01-110/05-1057, e datës 29.09.2022.

**Neni 2**

Te rregulloja bazë te neni 10 tek drejtoria e Kadastër, Pronës dhe Gjeodezisë për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale me Nr. 01-110/05-1057, e datës 29.09.2022, i shtohet edhe Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr. 05/2021 për ndryshim dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MEA) Nr. 09/2020 për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës Paluajtshme.

**Neni 3**

Pjesët tjera të rregullores bazë dhe rregulloja për ndryshim dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale me Nr. 01-110/05-1057, e datës 29.09.2022, mbesin të pa ndryshuara.

**Neni 4**

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave dhe pas publikimit në Web faqen.

Propozues: Kryetari i Komunës së Vitisë



AJ ESE - IZLAZNA - OUTGOING  
REPUBLIKA KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA  
Qeveria - Vlada Kosovës / GOVERNMENT OF KOSOVA  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije  
Ministry of Local Government Administration

Nr.  
Br.  
No.  
Data  
Datum  
Date.

-VI- 43 - 870/8  
15-12-2022



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministrinia e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Për:	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Bekim Azizi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Servet Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	
Përmes:	Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 15.12.2022 VI-43-870/6
Zyrtaret përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevati Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Leonora Bajrami, Zyrtare për monitorim të komunave	
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë se aktit të Komunës së Vitisë nga komisioni ndërministror	
Lloji i aktit:	Rregullore e Kuvendit të Komunës	

Inderuar Kryetar,  
Inderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së (QRK) Nr. 06/2021 për Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrite, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregulloren 01-110/05-1361 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Nr.01-110/05-1057 te datës 29.09.2022

I miratuar më datë: 30.11.2022

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.12.2022

Komisioni ndërministror, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.


Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim
1.	Rregulloren 01-110/05-1361 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Nr.01-110/05-1057 te datës 29.09.2022	<p>Rregulloren 01-110/05-1057 për taksa, ngarkesa dhe gjoba, e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vitisë, është shqyrtuar nga ministritë përkatëse, e të cilat pas vlerësimit kanë konstatuar se Rregullorja është në kundërshtim më dispozitat e legjislacionit në fuqi si vijon:</p> <p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukture:</p> <p>Fusha e Agjencionit kadastral</p> <p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë-AKK, analizoi Rregulloren Nr.01-110/05-1361 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Nr.01-110/05-1057, date 29.09.2022, miratuar nga KK Viti, me ç'rast konstatoi se tarifat e përcaktuara në nenin 10 "DREJTORIA PËR KADASTË, PRONË DHE GJEODEZI" është në pajtim me aktet nënligjore: Udhëzimet Administrative MEA Nr. 09/2020 për Tarifa e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës Paluajtshme, MMPPH Nr. 12/2019 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës dhe MMPPH Nr. 11/2019 për Narjen e Ndërtësës dhe Pjesës së Ndërtësës.</p> <p>Mirëpo, kjo rregullore nuk është bazuar dhe nuk ka përcaktuar tarifat e parapara me aktin nënligjor Udhëzim Administrativ (MMPH) Nr. 05/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MEA) Nr. 09/2020 për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës Paluajtshme.</p> <p>Prandaj, ndryshimet e parapara në këtë akt nënligjor duhet të pasqyrohen edhe në rregullore.</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Komisioni Ndërministror, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Vitisë që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimut të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Bashkangjitur gjeni raportet e vlerësimit të Ministrive të Linjës (MMPHI, MBPZHR, MD).

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova**

**Republic of Kosovo**

**Komuna e Vitisë**

**Opština Vitina**

**Municipality of Viti/na**

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 të Ligjit mbi Vetqeverisjën Lokale Nr.03L-040(Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008 lidhur me nenin 50 shkrona I të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 të dates 21.04.2011, në harmoni me Vlersimin e ligjshmerisë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor me numer protokolli 5864-2/22 të dates 11.10.2022 Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë;

## **PROPOZIM VENDIM**

**Për shfuqizimin e vendimit Nr.01-110/05-1071 për caktimin e lokacionit për ngritjën e obiliskit Madelein Albriht, në qytetin e Vitisë, të miratuar nga KK Viti, me datë 28.09.2022**

### **Neni I**

Me këtë propozim vendim propozohet Kuvendit të Komunës së Vitisë shfuqizimi i Vendimit Nr.01-110/05-1071 për caktimin e lokacionit për ngritjën e obiliskit Madelein Albriht, në qytetin e Vitisë, të miratuar nga KK Viti, me datë 28.09.2022

### **Neni II**

Me këtë propozim vendim I propozohet Kuvendit të Komunës së Vitisë shfuqizimi i Vendimit Nr.01-110/05-1071 për caktimin e lokacionit për ngritjën e obiliskit Madelein Albriht, në qytetin e Vitisë, të miratuar nga KK Viti, me datë 28.09.2022 me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës Nr.5864-2/22 të datës 11.10.22

### **Neni III**

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria për sherbime publike dhe emergjente dhe drejtorit tjera të Komunës së Vitisë.

### **Neni IV**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues, Kryetari i Komunës së Vitisë

Sokm. Hanu






REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKI NË KOSOVË  
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURE  
MINISTERSTVO ZIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njësia e  
Organizimi  
Org. Unit  
Ndi Taveve  
Da Strucia  
Nafogja


D2  
02

PRISHTINË / A  
5864-2/bc  
11.10.22

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure



Për:	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë, Bekim Azizi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Venera Çerkini, Zëvendësues e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMFPHI
Nga:	Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMFPHI
Zyrtarët përgjegjës:	<p>1.Zyrtari konfirmues i Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për vlerësimit ligor 2.Zyrtari hartues i Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legislacionit, të vlerësimit ligor</p> <p>i Mbështetjes Ligore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legislacionit</p>
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi Nr. 01-110/05-1071 për caktimin e lokacionit për ngritjen e obiliskit Madelein Albright, ne qytetin e Vitisë, miratuar nga KK Viti

Inderuari Kryetar, Haliti,  
Inderuari Kryesues, Azizi,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave më datë 04.10.2022, ka pranuar nga MAPL Vendimin Nr. 01-110/05-1071 për caktimin e lokacionit për ngritjen e obiliskit Madelein Albright, ne qytetin e Vitisë, miratuar nga KK Viti , datë 28.09.2022.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim më Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga Kuvendi i Komunës së Vitisë :

#### Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Vendimi Nr. 01-110/05-1071 për caktimin e lokacionit për ngritjen e obiliskit Madelein Albright, ne qytetin e Vitisë, miratuar nga KK Viti, datë 28.09.2022.

#### Arsyimi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të përbajtjes së vendimit Nr. 01-110/05-1071 për caktimin e lokacionit për ngritjen e obiliskit Madelein Albright, ne qytetin e Vitisë, miratuar nga KK Viti, konstatoi se:

- Vendimi duhet të jetë i bazuar në dokumentet e planifikimit hapësinor sipas Ligit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, dhe dokumentet tjera që janë të parapara me këtë ligj dhe të shikohet lokacioni i planifikuar sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor në fuqi.
- Nuk lejohet destinim tjetër apo shfrytëzueshmeri tjetër nga ajo që është e paraparë me dokumentet e planifikimit hapësinor pjesën tekstuale dhe pjesën grafike në fuqi sipas Ligit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor.


Po ashtu, të ri-shikohet Neni 2 i Vendimit pasi që është kundërshtim me Certifikatën e Njësisë kadastrale (të bashkangjitur në vendim).

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të mirret vendim i drejtë dhe i ligjshëm konform dispozitave ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

**Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për  
periudhën Janar - Dhjetor 2022**

**Dhjetor 2022**

**Nga: Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë**

**Për: Kuvendin Komunal të Vitisë**

**Tema: Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2022**

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunalë të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Kuvendit Komunal të Vitisë dhe komiteteve funksionale që janë të themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, për periudhën Janar- Dhjetor 2022.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, ka të themeluar edhe komitete obligative dhe komitetet joobligative.

Kuvendi Komunal i Vitisë për periudhën Janar-Dhjetor 2022, ka realizuar po thuaja që 100% realizimin e planit të punës se kuvendit për vitin 2022. Kuvendi Komunal i Vitisë për periudhën Janar-Dhjetor 2022, ka mbajtur gjithsej -XI- mbledhje të rregullta, -V- mbledhje solemne, dhe -I- mbledhje të jashtëzakonshme. Kuvendi ka miratuar gjithsej 81 vendime, 1 rregullore dhe 2 ndryshim plotësimë të rregulloreve, 1 deklaratë, ka shqyrtuar të gjitha kërkesat nga MAPL-ja.

Komiteti për Politik dhe Financa është komitet obligativ, i cili si çdo vit edhe në këtë vit është shumë aktiv, i cili deri me sot ka mbajtur -X- mbledhje.

Komiteti për Komunitete gjithashtu është komitet obligativ, i cili këtë vit ka mbajtur -X- mbledhje.

Përveç këtyre komitetave, kemi të themeluar edhe komitete të tjera, si:


1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale;
2. Komiteti për Shërbime Publike;
3. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
4. Komiteti për Liritë të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore;
5. Komiteti për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mirëmbajtjen të Mjedisit.

Pothuajse të gjitha komitetet e cekura me lartë joobligative, kanë qen aktiv, dhe për secilin komitet e keni të bashkangjitur informatën e përgatitur nga kryesuesit e komitetave.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

**Informatë mbi punën e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të  
Komunës së Vitisë për vitin 2022**

**Dhjetor 2022**

Për :	<b>Kuvendin Komunal të Vitisë</b>
Nga :	<b>Valentina Mehmeti - Kryesuese e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Vitisë</b>
Lënda:	<b>Informatë mbi punën e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Vitisë për vitin 2022</b>
Datë:	<b>13.12.2022</b>

## INFORMATË

Të nderuar Këshilltar të Kuvendit Komunalë të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Vitisë i cili është themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, informata për periudhën mars- dhjetor 2022.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, Udhëzimin Administrativ MAPL 05-2022 për procedurat e themelimit, përbërjen e kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komuna ka të themeluar edhe Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Vitisë , i cili komitet është themeluar me datën 01.03.2022.

Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Vitisë për periudhën mars-dhjetor 2022, ka miratuar planin e punës për vitin 2022, ka mbajtur gjithsej VI mbledhje të rregullta.

Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar këto takime:


1. Zgjedhja e kryesise se KSHMS
2. Pergaditja e planit vjetor per KSHMS
3. a)Raport per realizimin e kontrollave sistematike te nxenesve te shkollave fillore te Komunes se Vitise per vitin 2022  
b)Raport per vaksinimin e femijeve, nxeensve dhe qytetareve te Komunes se Vitise, si dhe per vaksinimin kunder gripit sezonal dhe vaksinen AntiCovid
4. Raporti i programit per vizita shtepiake per nena dhe femije ne kuader te QKMF-se ne Viti
5. Vizite QKMF-se ne Viti
6. Prezantimi i informates rreth aktiviteteve te realizuara per vitin 2022, si dhe plani i punës për vitin 2023

Komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale të Komunës së Vitisë, ka miratuar edhe planin e punës se këtij komiteti për vitin 2023 të cilin plan do ta dërgon në kuvend për miratim.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## **Informatë mbi punën e Komitetit për Shërbime Publike për periudhën Mars - Dhjetor 2022**

**Dhjetor 2022**

**Nga: Kryesuesi i Komitetit për Shërbime Publike**

**Për: Kuvendin Komunal të Vitisë**

**Informatë mbi punën e Komitetit për Shërbime Publike**

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunalë të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Komitetit për Komitetit për Shërbime Publike të Komunës së Vitisë i cili është themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, informata për periudhën mars- dhjetor 2022.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, Udhëzimin Administrativ MAPL, 05-2022 për procedurat e themelimit, përbërjen e kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komuna ka të themeluar edhe Komitetit për Komitetit për Shërbime Publike të Komunës së Vitisë, i cili komitet eshte themelu me datën 01.03.2022.

Komitetit për Shërbime Publike të Komunës së Vitisë për periudhën mars-dhjetor 2022, ka miratuar planin e punës për vitin 2022, ka mbajtur gjithsej -VI- mbledhje të rregullta, aq sa janë parapa në planin e punës së komitetit.

Komitetit për Komitetit për Shërbime Publike të Komunës së Vitisë, ka miratuar edhe planin e punës se këtij komiteti për vitin 2023 të cilin plan do ta dërgon në kuvend për miratim.


**Me datën: 12.12.2022**

**Kryesuesi i komitetit  
Bajri Sylejmani**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

**Informatë mbi punën e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës  
së Vitisë për periudhën Mars-Dhjetor 2022**

**Dhjetor 2022**

**Nga: Kryesuesi i Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë**

**Për: Kuvendin Komunal të Vitisë**

**Informatë mbi punën e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë**

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunalë të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë, i cili është themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, informata për periudhën mars- dhjetor 2022.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, Udhëzimin Administrativ MAPL, 05-2022 për procedurat e themelimit, përbërjen e kompetencave të komiteteteve të përhershme dhe komiteteteve tjera në komuna ka të themeluar edhe Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë, i cili komitet është themeluar me datën 01.03.2022.

Që nga themelimi i Komitetit në muajin Mars 2022, ka filluar puna e këtij Komiteti fillimisht në përpilimin e planit të punës së këtij Komiteti duke i dorëzuar Kuvendit Komunal planin e punës për miratim nga anëtarët e Kuvendit Komunal në muajin Maj 2022.

Fillimisht duke ofruar një bashkëpunim të shkëlqyer me DKA-në dhe DKRS-në, për çka jemi edhe falënderues ndaj dy drejtoreve për gatishmërinë e treguar që të punojmë së bashku me Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

Pastaj që nga muaji Maj është filluar me punën tonë si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, gjatë kësaj periudhe pasi kemi miratuar planin e punës, kemi filluar me vizitat nëpër shkollat fillore, për të parë më afér kushtet e punës dhe gjendjen e shkollave në komunën e Vitisë.

Shkollat të cilat i kemi vizituara në këtë fazë janë gjithsej 8 Shkolla fillore:

1. Shkolla Filllore “Bafti Haxhiu” Viti
2. Shkolla Filllore “Dëshmorët e Vitisë” Viti
3. Shkolla Filllore “Halil Alidema” Pozheran
4. Shkolla Filllore “Hysen Terpeza” Terpezë
5. Shkolla Filllore “Dëshmorët e Lubishtës” Lubishtë
6. Shkolla Filllore “Dom Mikel Tarabulluzi” Stubëll
7. Shkolla Filllore “Dëshmorët e 5 Prillit” Smirë
8. Shkolla Filllore “28 Nëntori” Vërban

Nga kjo vizitë na delë një e përbashkët:

- Të gjithë udhëheqësit e shkollave u pajtuan që duhet të rritet përgjegjësia, llogaridhënia, dhe respektimi i rregullave shkollore si nga ana e nxënësve, po ashtu edhe nga ana e mësimdhënësve.

- Të gjithë u pajtuam se orientimi në karrierë duhet të filloj që nga klasa e 6 fillore që nxënësit të mund të zgjedhin talentin e tyre dhe përgatitjen profesionale.
- Te të gjitha shkollat problemi ishte i njëjtë për trajtimin e inventarit të vjetër.

Pastaj në muajt Korrik-Gusht, kemi përcjellur aktivitetet kulturore për ditët e diasporës të cilët aktivitete ishin nën organizimin e DKRS-së, ku kishim disa aktivitete kulturore, rinore, sportive etj.

Me fillim të vitit mësimorë, pasi ky vit shkollorë nuk filloj ashtu sikur ishte paraparë në kalendarin vjetorë mësimorë, kishim një zvarritje të procesit mësimorë për një muaj rresht, për shkak të grevës së përgjithshme në arsim. Kjo situate u kalua dhe filloj procesi mësimorë në muajin Tetor 2022, ndërsa ne si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, filluam edhe vizitën e dytë nëpër disa shkolla të komunës së Vitisë.

Shkollat të cilat i kemi vizituar në këtë fazë janë:

1. Shkolla Fillore “Kenan Halimi” Skifteraj
2. Shkolla Fillore “Hasan Aliu” Remnik
3. Shkolla Fillore “Nazmi Pajaziti” Radivojcë
4. Shkolla Fillore “Skender Emerllahu” Ramjan
5. Shkolla Fillore “Nijazi Rexhepi” Sllatinë e Epërme
6. Çerdhja e Qytetit “Gëzimi Ynë” Viti
7. Shkolla Mesme Gjimnazi “Kuvendi i Lezhës” Viti
8. Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional – IAAP “Jonuz Zejnallahu” Viti

Nga kjo vizitë na delë një e përbashkët:

- Të gjitha shkollat janë furnizuar me lëndë djegëse (dru), për sezonën e dimrit.
- Të gjithë ishin për një bashkëpunim sa më të mirë me këshillat e prindërve që të mund të kontribuojmë të gjithë për një proces sa më të mirë edukativohet-arsimor.
- Si sfidë e të gjitha shkollave ishin kabinetet e ndryshme që mësimi të jetë sa më inovativ, si dhe shpejtësia e rrjetit ishte një problem i theksuar nëpër shkolla.
- Gjithashtu edhe një sfidë te pastërtia, ku nga të gjithë menaxherët e shkollave u kërkua që pastërtia e shkollave të bartet te ndonjë kompani private me qëllim të përmirësimit nivelit të pastërtisë.

Nga puna jonë si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport kemi vazhduar që të jemi në kontakt me organizatat e ndryshme jo qeveritare siç janë disa OJQ që veprojnë në komunën e Vitisë si dhe me disa shoqëri kulturore artistike që veprojnë në Viti si psh: AKV “Kemajl Azizi” në Viti.

Nga drejtori i AKV “Kemajl Azizi” z.Arsim Abazi u njoftuam për së afërm me rezultatet, sukseset dhe angazhimet e shoqërisë që drejton të cilat rezultate ishin mbresëlënëse për të gjithë ne duke marrë edhe çmime në nivel shtetërorë, ne si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport ju

ofruam bashkëpunim duke i inkurajuar që të vazhdohet me angazhim dhe punë në nxjerrjen e talenteve tanë, ku Vitia është një vatër e kahershme me talenta në fushën kulturore, artistike etj.

Në kuadër të punës si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport kemi pasur në takim në dy mbledhje drejtoreshën e DKA-së znj. Fatbardha Emini, për të diskutuar nga afér për sfidat në arsim dhe problemet që na rrethojnë në kuadër të fushës së arsimit, për çka edhe e falënderojmë drejtoreshën për një bashkëpunim të shkëlqyer me ne si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

Gjithashtu në mbledhje të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, prezent kishim edhe drejtorin e DKRS-së z. Valmir Sahiti, nga i cili u njoftuan për së afërmimi me punën e DKRS-së, aktivitetet, angazhimet, puna etj. Nga drejtori z. Sahiti jemi njoftuar edhe për së afërmimi edhe me mbështetjen financiare të OJQ-ve në komunën e Vitisë, për çka jemi falënderues për transparencën e treguar dhe gatishmërinë që në çdo kohë të mund të bashkëpunojmë për të mirën e qytetarëve Vitias.

Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë, për periudhën mars-dhjetor 2022, ka mbajtur gjithsej -VI- mbledhje të rregullta dhe 16 takime nëpër shkolla duke përfshirë: Shkollat e Mesme, Shkollat fillore dhe Qerdhën e Qytetit, si dhe në fushën e kulturës 4 takime, me përfaqësues të klubeve sportive etj.

Nga puna jonë si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport që nga marrja e detyrës jemi munduar që të jemi sa më bashkëpunues në mes veti pa dallim moshe, gjinie, e partie politike, duke i kaluar kështu edhe barrierat paragjykuese dhe duke u munduar të japim një mesazh se së bashku mund të ia dalim në arritjen e rezultateve për të adresuar problemet dhe sfidat e qytetarëve tanë, ku të ndërtohet një urë lidhëse në mes nesh si Komitet dhe ekzekutivit komunal.

Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë, ka miratuar edhe planin e punës se këtij Komiteti për vitin 2023, të cilin plan do ta dërgon në kuvend për miratim.

Me datën 13.12.2022


Kryesuesi i komitetit

Musli Neziri





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

**Informatë mbi punën e Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi  
Gjinore të Komunës së Vitisë për periudhën Mars - Dhjetor 2022**

**Dhjetor 2022**

**Nga: Kryesuesja e Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore të Komunës së Vitisë**

**Për: Kuvendin Komunal të Vitisë**

**Informatë mbi punën e Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore të Komunës së Vitisë për periudhën Mars-Dhjetor 2022**

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunalë të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore të Komunës së Vitisë i cili është themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, informata për periudhën Mars- Dhjetor 2022.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, Udhëzimin Administrativ MAPL, 05-2022 për procedurat e themelimit, përbërjen e kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komuna ka të themeluar edhe Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore të Komunës së Vitisë, i cili komitet është themelu me datën 01.03.2022.

Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore të Komunës së Vitisë për periudhën mars-dhjetor 2022, ka miratuar planin e punës për vitin 2022, ka mbajtur gjithsej -VI- mbledhje të rregullta aq sa janë parapa me planin e punës se këtij komiteti për vitin 2022.

Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore të Komunës së Vitisë, ka miratuar edhe planin e punës se këtij komiteti për vitin 2023 të cilin plan do ta dërgon në kuvend për miratim.


**Me datën: 12.12.2022**

**Kryesuesja e këtij komiteti  
Lindita Demelezi**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

**Informatë mbi punën e Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe  
mbrojtjen të mjedisit të Komunës së Vitisë për periudhën Mars - Dhjetor 2022**

**Dhjetor 2022**

**Nga: Kryesuesi i Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit të Komunës së Vitisë**

**Për: Kuvendin Komunal të Vitisë**

**Informatë mbi punën e Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit të Komunës së Vitisë për periudhën Mars-Dhjetor 2022**

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunalë të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit të Komunës së Vitisë i cili është themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, informata për periudhën mars- dhjetor 2022.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, Udhëzimin Administrativ MAPL, 05-2022 për procedurat e themelimit, përbërjen e kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komuna ka të themeluar edhe Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit të Komunës së Vitisë, i cili komitet eshte themelu me datën 01.03.2022.

Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit të Komunës së Vitisë për periudhën Mars-Dhjetor 2022, ka miratuar planin e punës për vitin 2022, ka mbajtur gjithsej -IV- mbledhje të rregullta.

Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit të Komunës së Vitisë, ka miratuar edhe planin e punës se këtij komiteti për vitin 2023 të cilin plan do ta dërgon në kuvend për miratim.

**Me datën: 13.12.2022**

**Kryesuesi i komitetit  
Remzi Salihu**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

Priuar - Praviljeni dñjane	12-12-2022		
Nr. i organit/ Dra. broj	Numri/Ebroj	Shtatësë Prilog	Vlera Mendore
	02-016/01-1h20		



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Vitina

## Informatë për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë

Viti, Dhjetor 2022

**Bazuar në identifikim rreziqeve në Planin e Integritetit për Komunën e Vitisë dhe propozim masat e marra për ruajtjen e integritetit të institucioneve komunale, ju informojmë për masat e ndërmarra nga organet e Administratës Komunale.**

Plani për të cilin po ju informojmë, ka pasur të të identifikuara një sërë fusha të rrezikut, si: Sistemi i menaxhimit financiar, rekhistrimi dhe menaxhimi i aseteve, menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerzore, inspektimi, gjeodezia, prona dhe kadastra, shëndetësia dhe mirëqenia sociale, bujqësia pylltaria dhe zhvillimii rural, shërbimet publike dhe gatishmëria emergjente si dhe komunikimi me akterët kryesorë të jashtëm

**Për realizimin e këtij plani, Instirucionet e Komunës kanë ndërmarrë një sërë masash të përmirësimit për të gjitha grupet në rrezik.**

Komuna e Vitisë, ka qenë e përkushtuar në menaxhimin e rrezikut të integritetit për tërë Organizatën, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë, në eliminimin e mundësive për korruption dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së përgjithëshme ndaj korruptionit, ku për përkushtimin e Komunës për zbatimin e këtij Plani më së miri flet edhe Raporti i Auditorit të Përgjithshëm, i cili raport nga ana e auditorëve cilësohet si raport i pakualifikuar.

**Masat të cilat janë ndërmarrë nga Komuna për sistemin e menaxhimit financiar dhe rekhistrimin e menaxhimit të aseteve janë:**

- Hartimi i buxhetit konform kufijve buxhetor nga Qarkoret Buxhetore nga Ministria e Financave
- Zbatimi i plotë i Rregullores për Tarifa, Taksa, Ngarkkesa dhe Gjoba
- Zhvillimi i procedurës gjithëpërfshirëse të brendshme për menaxhimin e buxhetit me përshkrim të qartë të aktiviteteve të ndërlidhura të raportimit dhe linjave llogaridhënëse
- Zbatimi i sanksioneve për mospërmbushjen e obligimit për pagesën e taksave dhe tarifave
- Sigurimi i kapaciteteve të brendshme profesionale të stafit nëpërmjet trajnimit të specializuar
- Përmirësimi i menaxhimmit të aseteve dhe cilësisë së kontrolleve, ku për këtë është themeluar një komision i cili ka bërë vlerësimin dhe amortizimin e aseteve.

**Masat të cilat janë ndërmarrë për menaxhimin e burimeve njerëzore janë:**

- Është menaxhuar me sukses procesi i rekrutimit të punëtorëve të rinjë
- Është zbatuar plotësish Rregullorja për Procedurat e rekrutimit
- Është hapur një link i veçantë në Ëeb faqen zyrtare të Komunës për ankesat që kanë të bëjnë me rekrutimin

- **Eshtë menaxhuar me sukses si nga Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtoirve monitorimi i disiplinës në punë**
- **Eshtë menaxhuar me sukses kontrolli i udhëtimeve zyrtare**

**Masat të cilat janë ndërmarrë në Inspektim:**

- **Përmirësimi i financimit të funksionit të inspektimit eshtë menaxhuar me sukses**
- **Eshtë bërë rritja e profesionalizmit të stafit sa i përket teknikave të veçanta**
- **Janë shtuar inspektimet Ad Hoc**
- **Eshtë realizuar me sukses Plani i inspektimit**

**Masat të cilat janë ndërmarrë në Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër:**

- **Janë mbajtur trajnime adekuate profesionale për stafin e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë për vlerësim të pasurive të patundshme, udhëzimeve ose kornizave për matjen e kadastrës**
- **Eshtë siguruar transparencë e plotë në Drejtori duke krijuar hapësirë për punë**
- **Eshtë rritur integriteti në rekhistrimin e pronës së paluajtshme si dhe eshtë bërë futja dhe mbajtja e një sistemi funksional të skanimit dhe arkivimit profesional**
- **eshtë menaxhuar me sukses rekhistrimi dhe çrekhistrimi i hipotekave në raport me bankat, noterin dhe organet tjera gjegjëse**

**Masat të cilat janë ndërmarrë në Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:**

- **Eshtë bërë koordinimi me Sektorin e Buxhetit sa i përket planifikimit të buxhetit për nevojat e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale**
- **Janë rritur fondet për shëndetësi**
- **Eshtë rritur stafi shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore**
- **Eshtë përmirësuar infrastruktura në objektet shëndetësore**
- **Eshtë zbatuar në përpikëri Rregullorja për ndarjen e subvensioneve**

**Masat të cilat janë ndërmarrë në Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural:**

- **Eshtë bërë përcaktimi i sektorëve që duhet të jepen subvensione, ku subvensionet më të mëdha janë dhënë në sektorin e Bujqisë**
- **Eshtë menaxhuar me sukses transparenca, efektivitetit dhe efikasiteti në ndarjen e subvensioneve**

- Stafi i Drejtorisë është trajnuar në mënyrë adekuate

**Masat të cilat janë ndërmarrë në Shërbime Publike dhe Gatishmëri Emergjente:**

- Është menaxhuar me sukses procesi i menaxhimit të kontratave të shërbimit
- Janë ngritur kapacitetet e stafit të përfshirë në hartimin e projekteve, kjo përmes trajnimeve adekuate
- Drejtoria ka marrë pjesë aktive në procesin e planifikimit të buxhetit duke identifikuar nevojat për planifikim buxheti

**Masat të cilat janë ndërmarrë në Komunikim me akterët e jashtëm:**

- Zhvillimi i masave për të komunikuar me akterë të jashtëm është menaxhuar me sukses ku edhe janë mbajtur 14 dëgjime buxhetore
- Është bërë prezantimi i portalit të transparençës në Web Faqen zyrtare të komunës, ku edhe janë publikuar dokumenti buxhetor i Komunës së Vitisë si dhe pasqyrat financiare të shpenzimeve publike
- Përmes fushatave sensibilizuese, shpërndarjes së fletëpalosjeve është bërë vetëdijësimi i qytetarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre
- Është bërë fuqizimi i zbatimit të mekanizmave të krijuara për dorëzimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve, ku qytetarët kanë mundësinë që ankesat e tyre ti dërgojnë edhe në Web faqen zyrtare të Komunës

Viti, Dhjetor 2022

Kryetari i Komunës

Sokol HALITI





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



Komuna e Vitise  
Opština Vitina  
Municipality of Vitina

## INFORMATË PËR ZBATIMIN E PLANIT TË KKSBB-së PËR VITIN 2022

Viti, Dhjetor 2022

Bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.27/2012MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe Planin e Punës së KKSBB-së për vitin 2022, ku kanë qenë të parapara një sërë objektiva dhe aktivitete për realizmin e këtyre objektivave, KKSBB ka kryer këto aktivitetet:

- Janë mbajtur 6 takime të KKSBB-së, ku në këto takime përvèç raportimit të rregullt të gjendjes së sigurisë në Komunë e Vitisë, nga Policia e Kosovës, janë shtjelluar tema të ndryshme rreth çështjes së sigurisë publike të qytetarëve.
- Në lokalitete të ndryshme të Komunës së Vitisë është rregulluar sinjalistika horizontale dhe vertikale në komunikacion
- Janë rregulluar trotuare në shumë zona të komunës
- Është rregulluar ndriqimi publik në disa zona të Komunës
- Policia e Kosovës, bazuar në Planin e KKSBB-së dhe në planet e saja operacionale ka kryer një sërë aktivitetë të cilat janë realizuar në komunitet dhe me nxënës në shkolla e të cilat janë:

Organizimi i ligjëraturëve në disa shkolla të Komunës së Vitisë me këto tema: Parandalimi i trafikimit me njerëz, Parandalimi i dhunës në familje, lajmet e rreme (Fake News), parandalimi i përdorimit të narkotikëve, keqpërdorimi i rrjeteve sociale (krimet kibernetike), ku këto aktivitete janë realizuar edhe nga QPS, psikologë shkollorë dhe gazetarë lokalë

- Janë formuar ekipet e nxënësve për siguri në shkolla, të cilat do të identifikojnë problemet e nxënësve që cenojnë sigurinë e nxënësve në shkollë dhe do të propozojnë masa për parandalimin dhe luftimin e tyre
- Është funksionalizuar Këshilli Komunal për Parandalimin e Dukurive Negative nga të rinjët, i cili këshill është duke hartuar propozim masa të reja në parandalimin e këtyre dukurive
- Komuna në bashkëpunim me forumet e sigurisë siç janë Policia dhe EVSB ka shënuar javën për të drejtat e viktimate të krimtit, ku janë shpërndarë posterë me moton “Thyeje heshtjen, raporto viktimat e krimtit”
- Komuna e Vitisë, ka shpallur vitin 2022 vit të mbrojtjes së pyjeve, ku në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe sektorin e pyjeve janë vendosur pikat statike për kontrollimin e pyjeve në mëyrë të pengimit të dëmtimit të pyjeve nga persona të papërgjegjshëm si dhe ka shpërndarë posterë me mesashe për mbrojtjen e pyjeve
- Policia e Kosovës vazhdimisht ka bërë patrullimin e rrugëve frekuentive me nxënës të shkollave si dhe gjatë orarit të vajtjes së tyre në shkollë dhe anasjelltas

- Mbajtja e takimeve të rregullta ndër institucionale dhe ndër komunale : KKSBS-EVSK-KLSB, të tjera
- Trajnim i vazhdueshëm i zyrtarve policer për konceptin e policimit në bashkësi
- Policia e Kosovës përmes planeve operative dhe të vazhdueshme ka ushtruar kontrollë të trafikut rrugor për të zvogluar aksidentet
- Zyra përt Riatdhesim ka ofruar vazhdimesh shërbime dhe udhëzaime për personat e riatdhesuar
- Policia e Kosovës në vazhdimesi ka zbatuar Planin operativ për siguri në shkolla, ku rregullisht ka monitoruar sigurinë në shkolla
- Policia e Kosovës ka bërë rregullisht patrullimin e rrugëve gjatë fushatës së korje shirjeve përgjatë muajit Korrik
- Policia e Kosovës ka bërë patrullimin e rregullit në trafik gjatë qëndrimit të mërgimëtarve në vendlindjet e tyre ( përgjatë muajit Korrik – Gusht)
- Me datë 20 Tetor është bërë hapja e fushatës kundër trafikimit me qenie njerëzore me moton “ Mos Hesht ”, ku është mbajtur tryezë me përfaqësues nga niveli lokal dhe qendror, ku secili nga përfaqësuesit ka prezantuar angazhimet dhe obligimet që kanë në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie si dhe për në muaj janë mbajtur aktivitete të shumta me nxënës në shkollat e mesme të larta si dhe në ato të mesme të ulëta
- Me datë 25 Nëntor është bërë hapja e fushatës për parandalimin e dhunës në familje me moton “ Asnjë më shume ” e cila është shënuar 16 ditë me aktivitete të shumta në shkolla dhe komunitet dhe janë shpërndarë posterë me mesazhe sensibilizuese për parandalim dhe raportim të rasteve viktima të dhunës

Dhjetor, Viti

